

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT
PËR SHOQËRINË “TV-ALSAT” SHA

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë prej:
Niko Rapi - kryetar i trupit gjykues (gjyqtar i vetëm),
asistuar prej sekretares Anjeza Nergjoni, në Tiranë, sot, më datë 28.12.2023, ora 11:00, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me nr. 15251/8705 regj. themeltar, datë regj. themeltar 27.9.2022, që iu përket palëve:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), e përfaqësuar në gjykim sipas autorizimit të posaçëm nr. 8573 prot., datë 8.3.2023, nga juristja Aurora Vorfi; sipas autorizimit të posaçëm nr. 17362 prot., datë 27.4.2023 nga Medi Duka; sipas autorizimit të posaçëm nr. 78526 prot., datë 23.11.2023 nga Anila Meshi; sipas autorizimit të posaçëm nr. 82070 prot., datë 4.12.2023 nga Endrit Hoxha;

gjykim i zhvilluar *në prani të Avokaturës së Shtetit*, e cila ka qenë e njoftuar dhe e pranishme në të gjitha seancat gjyqësore, nëpërmjet avokates së shtetit Nertila Shabani, sipas neneve 79/a dhe 128 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile (*shënuar në kërkesë si palë e interesuar*).

PERSON I TRETË (person i interesuar): Shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.), shoqëri e regjistruar me NUIS: K21407006R, me seli në adresën: Bashkia Tiranë, rruga “Siri Kodra” (pranë ish-Frigoriferit), me administrator Bledar Lilo (sipas ekstraktit të QKB-së për të dhënat identifikuese të personit juridik, pikat 1, 3, 4, 7, 10, 12, 14, që tregojnë personin fizik si administrator dhe të dhënat e tjera identifikuese të personit juridik si aktivitetin, përfaqësuesin, emërimin, kohëzgjatjen, statusin etj.), *e gjykuar në mungesë, njoftuar me shpallje*.

OBJEKTI: Kërkesë për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.).

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008.

Neni 104, pika “c” i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”.

Gjykata, pasi shqyrtoi provat shkresore dhe zhvilloi një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm për të gjitha kërkesat dhe rrethanat, sipas legjislacionit të posaçëm; pasi dëgjoi përfaqësuesin e *palës kërkuese*, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe çeljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.); pasi dëgjoi përfaqësuesin e *Avokaturës së Shtetit* që, gjithashtu, kërkoi pranimin e kërkesës dhe çeljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.); pasi dëgjoi *administratoren e falimentimit/eksperten* e caktuar Shpresa Breçani, e cila relatoi raportin (aktin e ekspertimit) kontabël dhe iu përgjigj në seancë gjyqësore pyetjeve plotësuese, duke u shprehur për hapjen e procedurës së falimentimit, në kushtet kur gjykimi u zhvillua në mungesë të vetë *shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a.* (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.);

si dhe pasi shqyrtoi provat e paraqitura dhe analizoi çështjen në tërësi,

VËREN SE:

A. Paraqitja e çështjes (kërkesës); juridiksioni dhe kompetenca lëndore e tokësore; rrethanat procedurale të çështjes

A.1 Kërkuesi, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, i ka paraqitur Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) një kërkesë, me anë të së cilës ka kërkuar: “Kërkesë për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë ‘TV-ALSAT’ sh.a.”.

A.2 Në bazë të neneve 36, 41, 43/1, 320/par. 1, pika “b”, 334/par. 1, pika “dh” dhe 335/1 të Kodit të Procedurës Civile, kjo çështje hyn në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate, **pasi është gjykata e vendit (seksioni tregtar) ku ka qendrën dhe selinë personi juridik për të cilin po kërkohet hapja e procedurës së falimentimit**, si një formë e veçantë e prishjes (dhënies fund të veprimtarisë) së një shoqërie tregtare dhe duke pasur parasysh këtu edhe parashikimin e vetë ligjit të posaçëm me nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar.

Konkretisht, nenet 3 dhe 4/1 të këtij ligji (si ligji në fuqi në kohën e depozitimit të kësaj kërke, e cila është depozituar në kryesekretari më datë 11.9.2009, ndërsa në referim të ligjit aktual në fuqi më nr. 110/2016, “Për falimentimin”, janë të zbatueshme nenet 9 dhe 11 të tij), sipas të cilit procedura e falimentimit (e ndryshme nga procedura e likuidimit të thjeshtëzuar) ndiqet e zhvillohet në rrugë gjyqësore në gjykatën e vendit (seksioni tregtar), ku personi juridik ka qendrën e tij, gjykatë pranë së cilës vepron **“Gjykata e Falimentimit”**.

Kështu, në lidhje me kompetencën për shqyrtimin e çështjeve me natyrë tregtare dhe, posaçërisht, të çështjeve që lidhen me procedurat e falimentimit, në nenet 320, 334, 335 të K. Pr. Civile është parashikuar se:

“Neni 320

(Shfuqizuar shkronja “a”, me ligjin nr. 49/2012, dhe ndryshuar shkronja “b”, me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Në përbërje të gjykatave të shkallës së parë krijohen seksione të veçanta për gjykimin e:

- a) shfuqizuar;*
- b) mosmarrëveshjeve tregtare dhe të procedurave të falimentimit;
- c) mosmarrëveshjeve që lidhen me të miturit dhe familjen.

KREU III

GJYKIMI I MOSMARRËVESHJEVE TREGTARE

Neni 334

Kompetencat

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, dhe me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Në kompetencë të seksioneve për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare pranë gjykatave të shkallës së parë janë:

a) mosmarrëveshjet kontraktore midis shoqërive tregtare e ndërmjet tyre dhe personave fizikë të regjistruar si tregtarë, ose ndërmjet vetë këtyre personave fizikë të regjistruar si tregtarë, kur është veprimtari tregtar për të dyja palët. Transaksionet e kryera nga një person fizik i regjistruar si tregtar, prezumohen të jenë pjesë e aktivitetit tregtar të tij, përveç rasteve kur provohet ndryshe;

b) mosmarrëveshjet ndërmjet ortakëve të shoqërive tregtare, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve të saj, si dhe ndërmjet shoqërisë ose ortakëve të saj dhe organeve të saj administruese, kur mosmarrëveshjet lindin nga pozicioni i tyre në shoqëri, si dhe paditë e kreditorëve të ngritura sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;

c) mosmarrëveshjet lidhur me kontratën e tjetërsimit të të drejtave të anëtarëve të një shoqërie tregtare;

ç) mosmarrëveshjet për të drejtën e emrit tregtar;

d) shkelja e rregullave për mbrojtjen e konkurrencës;

dh) procedurat e falimentimit;

e) mosmarrëveshjet që rrjedhin nga prishja e shoqërive tregtare;

ë) pretendimet për një kambial, çek e letra të tjera të kësaj natyre, të parashikuara me ligj.

Padia sipas nenit 334 të këtij Kodi shqyrtohet nga seksioni përkatës i gjykatës së shkallës së parë, në zonën e së cilës ka qendrën personi juridik a fizik tregtar i paditur, përveç kur palët në kontratë kanë caktuar një gjykatë tjetër, që edhe ajo është kompetente.

Kur padia paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ka qendrën personi juridik a fizik tregtar, kjo ia dërgon atë jo më vonë se tri ditë gjykatës, ku është krijuar seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare.”

A.3. Me vendimin nr. 2986, datë 3.3.2014, pas shqyrtimit në shkallë të parë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ...”*.

Mbi ankimin e palës kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, pas shqyrtimit në shkallë të dytë dhe për shkelje procedurale që lidhen me mosnjoftimin e rregullt të Avokaturës së Shtetit, me vendimin nr. 389, datë 16.2.2015, Gjykata e Apelit Tiranë (sot Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 2986, datë 3.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues ...”*.

Mbi rekursin e palës së interesuar (pala e tretë, sikundër është pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi), me vendimin nr. 1677, datë 6.7.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personi i interesuar në këtë gjykim, shoqëria ‘TV-ALSAT’ sh.a., kundër vendimit nr. 389, datë 16.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë”*.

- **Në rigjykim**, kjo Gjykatë ka nisur procesin me caktimin dhe kalimin e çështjes direkt në seancë gjyqësore duke urdhëruar njoftimin e të gjitha palëve, sipas detyrave procedurale të lëna nga gjykata më e lartë.

Kështu, pas njoftimit dhe legjitimitimit të përfaqësuesve **të palës kërkuese** dhe **të Avokaturës së Shtetit**, në zbatim të detyrave procedurale të lëna për rigjykim (nenet 128 e vijuese, 79/a, 90, 92 të Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit të posaçëm “Për Avokaturën e Shtetit”), janë kryer një sërë veprimesh procedurale dhe administrative për të bërë të mundur njoftimin dhe pjesëmarrjen e palës së interesuar, **të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a.** (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.), për të cilën është kërkuar hapja e procedurës së falimentimit, kërkesë kjo e bazuar në ligjin e kohës kur është paraqitur kërkesa, konkretisht, në ligjin nr. 8901/2002, të ndryshuar.

Ka rezultuar se, në mënyrë të përsëritur, nga Gjykata është dërguar akti i thirrjes (fletëthirrja) në adresën që figuron si seli e shoqërisë, sipas ekstraktit të QKB-së, konkretisht, në Tiranë, rruga “Siri Kodra”, pranë ish-Frigoriferit, ku nga ana e nëpunësit gjyqësor është bërë shënimi: *“Adresë e pamjaftueshme”*; shënimi: *“Nuk ekziston më, në këtë adresë nuk ka njeri”*; shënimi: *“Sipas banorëve, nuk ka njeri në këtë adresë”*; shënimi: *“Sipas banorëve, ka ikur nga kjo adresë”*; shënimi: *“Ky numër nuk ekziston dhe shoqëria është mbyllur”*; shënimi: *“Adresë e pamjaftueshme, numri i telefonit nuk ekziston”* (sipas seancave dhe fletëthirrjeve që ndodhen në dosje për seancat gjyqësore të mëposhtme: datë 9.3.2023, datë 29.3.2023, datë 25.4.2023, datë 2.5.2023).

Po kështu, nuk ka qenë e mundur që në kuadër të këtij procesi të realizohet njoftimi me telefon apo në adresën elektronike të shoqërisë (neni 141 i K. Pr. Civile), si dhe as në adresën e banimit të administratorit të shoqërisë, konkretisht, në adresën e shtetasit Bledar Lilo, që sipas pikës 14 të ekstraktit të QKB-së figuron me cilësinë e administratorit të emëruar për periudhën datë 27.10.2020–datë 27.10.2023 (shih për këtë *ekstraktin e shoqërisë*, si dhe *dokumentacionin plotësues të palës kërkuese*, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën në sistemin e tatimeve shtetasi Bledar Bardhyl Lilo, i datëlindjes 25.11.1980, me nr. tel. 0692176676, figuron si administrator dhe përfaqësues ligjor i kësaj shoqërie, si edhe *aktet e njoftimit* për këtë shtetas të thirrur në cilësinë e administratorit dhe përfaqësuesit ligjor të kësaj shoqërie).

E ndodhur në këto kushte, **me qëllim për të garantuar një proces të rregullt ligjor, në thelb të të cilit është njoftimi i çdo subjekti të së drejtës për të marrë pjesë në një gjykim civil dhe për të mos u gjykuar pa u thirrur** (në zbatim të nenit 6 të KEDNJ-së, të nenit 42 të Kushtetutës së RSH-

së, si dhe të neneve 18, 19, 20, 128 e vijuese të K. Pr. Civile), kjo Gjykatë ka kryer edhe veprime të tjera për të bërë të mundur njoftimin dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesit ligjor të kësaj shoqërie.

Kështu, është kërkuar informacion me shkrim nga Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC) pranë Bashkisë Tiranë, ku ka pasur regjistrimin, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), shtetasi Bledar Lilo, veprime në kuadër të të cilave janë administruar dhe janë relatuar shkresat e ZGJC-së me nr. 931/1 prot., datë 17.3.2023, nr. 680 prot., datë 20.3.2023, nr. 675 prot., datë 16.3.2023, por përsëri njoftimi ka qenë i pamundur.

Ndërkohë, në rigjykim ka qenë i pamundur njoftimi, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i palës së interesuar, i shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.) as nëpërmjet avokatit të legjitimuar, në kuadër të gjykimit të parë të mbyllur me vendimin nr. 2986/2014, konkretisht, nëpërmjet av. Julian Mërtiri dhe av. Eno Bushi, për të cilët është urdhëruar njoftimi në adresën e ushtrimit të profesionit si avokat dhe ku për secilin është bërë shënimi, sipas qëndrimit të tyre se nuk e përfaqësojnë më këtë shoqëri (në fletëthirrjen përkatëse nga nëpunësi gjyqësor është bërë shënimi: “*Avokati më tha se nuk e përfaqëson më si klient*”; shënimi tjetër: “*Avokati më thotë se nuk e ka më si çështje*”; apo shënimi për seancën vijuese, se: “*avokati Julian Mërtiri nuk e pranoi marrjen e fletëthirrjes, duke thënë se kjo shoqëri ka falimentuar*”; apo shënimi: “*avokati Eno Bushi nuk e pranoi marrjen e fletëthirrjes, duke thënë se kjo shoqëri ka falimentuar*”).

Në këto rrethana, kur nuk është bërë i mundur njoftimi i palës së interesuar, i shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), në asnjërën nga mënyrat e parashikuara në ligjin procedural dhe për të cilat janë kryer veprimet e lartpërmendura (*i. nëpërmjet dorëzimit të aktit; të thirrjes personit të thirrur apo përfaqësuesit në adresën zyrtare në QKB, sipas nenit 129 e vijues; ii. nëpërmjet telefonit ose në adresën elektronike, sipas nenit 141; iii. në adresën e vendbanimit të administratorit të shoqërisë, sipas nenit 129 e vijues; iv. nëpërmjet avokatit të pajisur me tagra si përfaqësues, sipas neneve 90, 92, 96/1/a dhe 128 e vijuese*), nga ana e kësaj Gjykate është vlerësuar se punonjësi i gjykatës **ka marrë të gjitha masat e nevojshme** për gjetjen e adresës së personit që i drejtohet njoftimi dhe se ky njoftim nuk është realizuar në asnjë nga format e parashikuara nga nenet 129, 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile, situatë që lejon dhe dikton **njoftimin me shpallje publike**, kjo sipas nenit 133/a, par. 1, pika “a”, të po këtij Kodi (dispozitë e shtuar me ligjin nr. 38./2017, hyrë në fuqi në datë 5.11.2017).

Në vijim, është proceduar **me njoftimin me shpallje me afat jo më pak se 20 ditë** të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), shpallje që ndër të tjera është afishuar në gjykatë, në QKB dhe në adresën ku kjo shoqëri ka selinë e saj në regjistrat publikë, sikundër parashikon neni 133/a, par. 1-2-3 për personat juridikë privatë, si në rastin konkret, duke disponuar kështu për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së interesuar (të palës së tretë), shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.), bazuar në nenet 125, 175, 179, 133/a-b, 195 të Kodit të Procedurës Civile (shih seancën gjyqësore datë 1.6.2023 ku është marrë vendimi i ndërmjetëm për gjykimin në mungesë të palës së tretë).

A.4 Pikërisht, këto rrethana që janë përmendur pak më lart në lidhje me historikun e gjykimit **e kanë bërë të pamundur marrjen në shqyrtim dhe disponimin** nga Gjykata e Falimentimit lidhur me kërkesën për hapjen ose jo të procedurës së falimentimit për shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), **brenda afateve ligjore** të përcaktuara në legjislacionin e posaçëm (*qoftë sipas ligjit të mëparshëm nr. 8901/2002, qoftë sipas ligjit të ri nr. 110/2016*).

Si shkaqe të tilla që kanë pamundësuar përfundimin brenda afateve ligjore nga kjo Gjykatë përmenden:

i. kalimi i çështjes së regjistruar që në shtator 2009 në të gjitha instancat gjyqësore, duke u dhënë vendimet përkatëse në të tria shkallët e gjykimit dhe këtij trupi gjykues çështja i ka kaluar pas prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe *kthimit për rigjykim*;

ii. vështirësitë që ka hasur ky trup gjykues në rigjykim *për njoftimin e shoqërisë dhe të përfaqësuesit ligjor të saj*, të administratorit Bledar Lilo, si një detyrim ligjor që rrjedh si nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, që rregullojnë një gjykim të zakonshëm civil, ashtu edhe nga dispozitat e ligjit të

posaçëm “Për falimentimin”, ku parashikohet (ndër të tjerash) edhe njoftimi i detyrueshëm i debitorit, i ortakëve, i administratorit, si dhe marrja e dokumentacionit;

iii. vështirësitë që ka hasur ky trup gjykues në rigjykim *për mbledhjen e dokumentacionit* lidhur me pasuritë, aktivet dhe detyrimet e shoqërisë, si dhe për kryerjen e *një ekspertimi të ri kontabël* nga ana e ekspertës/administratores së falimentimit, duke qenë se kërkesa ishte paraqitur në vitin 2009, vendimi në shkallë të parë është dhënë në vitin 2014 (vendimi nr. 2986, datë 3.3.2014) dhe kërkesa në rigjykim po shqyrtohet në vitin 2023, pra, ka pasur një hapësirë kohore mbi 10 vjet nga depozitimi i kërkesës, si dhe duke parë edhe detyrimin për një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm që, si parim i përgjithshëm procedural i parashikuar nga nenet 14, 29 të K. Pr. Civile, në referim të nenit 5 të ligjit nr. 8901/2002 (si ligji i zbatueshëm) shtrihet dhe është i zbatueshëm edhe në një gjykim të tillë të veçantë me natyrë tregtare.

B. Rrethanat e çështjes; faktet dhe provat e përmendura e të shqyrtuara mbi kërkesën e palëve ndërgjyqëse; pretendimet e palës kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore

B.i. Kërkesa për gjykim e paraqitur në vitin 2009

Në kërkesën për gjykim, të depozituar në datë 11.9.2009, pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), ka parashtruar se shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., e cila është regjistruar si shoqëri tregtare me NUIS: K21407006R, ka fituar personalitet juridik me vendimin nr. 24512, datë 11.9.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si shoqëri anonime me veprimtari në fushën radiotelevizive, me aksionar kryesor shoqërinë “VeVe Grup” dhe shtetasin Vebi Velija, me kapital themeltar, fillimisht në shumën 2.000.000 lekë, i rritur në vitin 2002 në shumën 450.000.000 lekë, ndërsa në vitin 2004 është realizuar zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë në shumën 487.500.000 lekë.

Pala kërkuese ka parashtruar, se në sistemin tatimor të RSH-së shoqëria **ka rezultuar me humbje për tre vjet të njëpasnjëshëm.**

Sipas palës kërkuese, në bazë të nenit 104/pika “c” të ligjit nr. 9902/2008, të ndryshuar, kjo situatë e jep të drejtë që të kërkojë hapjen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri, duke qenë se sipas kësaj dispozite është në kompetencë të administratës tatimore që të kërkojë në gjykatë fillimin e kësaj procedure për shoqëritë tregtarë si tatimpagues, kur këto shoqëri deklarojnë rezultat me humbje të kapitaleve të veta për të paktën 3 vjet rresht (*fajë 2 e kërkesës për gjykim*).

Në këto kushte, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT) ka paraqitur kërkesën objekt gjykimi dhe ka kërkuar caktimin e një seance gjyqësore për marrjen e saj në shqyrtim, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008, të ndryshuar, duke sjellë në kuadër të gjyimit të gjithë dokumentacionin që është dorëzuar dhe administruar nga organet e administratës tatimore në RTSH (ekstrakti i shoqërisë; të dhënat lidhur me detyrimet në fushën tatimore; bilancet e depozituara dhe pasqyrat financiare për tre vjetët e fundit në momentin e depozitimit të kërkesës në shtator 2009 etj.).

Sa më sipër, u parashtrua nga gjykata, rezultoi se nga pala kërkuese të gjitha këto akte formale dhe të detyrueshme u paraqitën si të tilla në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga ligji (neni 15 i ligjit nr. 8901/2002, i ndryshuar, në lidhje me nenin 251 të K. Pr. Civile).

B.ii. Gjykimi në shkallë të parë, me vendimin nr. 2986/2014, si dhe në Gjykatën e Apelit në vitin 2015 dhe në Gjykatën e Lartë në vitin 2022

- Sikundër është thënë pak më lart në pjesën lidhur me rrethanat procedurale të këtij gjykimi, ka rezultuar se me vendimin nr. 2986, datë 3.3.2014 pas shqyrtimit të kërkesës në shkallë të parë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ...”.

Në pjesën arsyetuese, për sa i përket zgjidhjes së çështjes në themel, ajo Gjykatë ka argumentuar se (citim i pjesës që konsiderohet si e nevojshme nga kjo Gjykatë **në rigjykim**):

“... Nga shqyrtimi gjyqësor dhe provat e administruara, rezulton i provuar fakti sa më poshtë:

Shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht “ALSAT” sh.a.), ka fituar personalitet juridikë nëpërmjet vendimit nr. 24512, datë 11.9.2000, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si shoqëri anonime me objekt në fushën e veprimtarisë radiotelevizive, me aksionar kryesor shoqërinë “VeVe Grup” dhe z. Vebi Velija, me kapital themeltar,

fillimisht në shumën 2.000.000 lekë, i rritur në vitin 2002 në shumën 450.000.000 lekë. Në vitin 2004, është realizuar zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë në shumën 487.500.000 lekë.

Më datë 2.9.2009, rezultojnë të jetë depozituar në QKR trashëgimia ligjore e aksionarit Vebi Velija, duke hyrë në vend të tij trashëgimtari Ferik Velija.

Nga ekstrakti historik i shoqërisë, konfirmohen problematikat në lidhje me aksionarët e shoqërisë, situatë e jo e stabilizuar përfundimisht më datë 27.6.2013, sipas së cilës rezultojnë si aksionarë të shoqërisë: Vasil Dede, me 30% të aksioneve; Irgen Selfo, me 30% të aksioneve, dhe Rezart Taçi me 40% të aksioneve.

Asambleja e re e aksionarëve të shoqërisë, me vendimin e datës 1.10.2013 ka vendosur: Miratimin e llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 1.1.2012 deri më 31.12.2012, ku shoqëria rezultojnë me humbje vjetore prej 30.413.514 lekësh. Miratimin e mosshpërndarjes së fitimit për faktin se shoqëria rezultojnë me humbje. Miratimin sipas kontratës për blerje aksionesh datë 13.2.2013, të heqjes dorë të aksionarëve nga financimet e kryera në shoqëri, me vlerë 897.060.018 lekë, të cilat do të përdoren për mbulimin e humbjeve të mbartura me vlerë 926.115.593 lekë.

Fakti i mësipërm, u bë objekt i kontrollit edhe nga ana e administratores së përkohshme të falimentimit thirrur nga kjo Gjykatë, ekspertja Ana Osmani, nëpërmjet materialeve të përpiluara nga ana e saj në formën e raporteve mbi verifikimin e kushteve të falimentimit të personit të tretë.

Nga parashtrimi i mësipërm i fakteve, në analizë të provave të paraqitura në gjykim dhe në referencë të dispozitave ligjore të ligjit material “Për falimentimin”, gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e DRT Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe në prova për sa më poshtë:

Së pari, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, në momentin e depozitimit të kërkesës në Gjykatë, i është njohur **legjitimimi aktiv** për paraqitjen e saj nëpërmjet ligjeve specifike të hyra në fuqi në vitin 2008. Neni 104, pika 1 “c”, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”, parashikon se administrata tatimore, kërkon në gjykatë fillimin e procedurave të falimentimit për tatimpaguesit, shoqëri tregtare ..., që deklarojnë rezultat me humbje të kapitaleve të veta për të paktën tre vjet rresht. Po kështu, në nenin 14.1 të ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008, “Për falimentimin”, përcaktohen si subjekt që legjitimohen për fillimin e procedurës së falimentimit “organet tatimore”.

Pra, DRT Tiranë **gëzon legjitimim aktiv për çeljen e procedurës së falimentimit**, por, në rastin konkret, parashikimet e mësipërme ligjore nuk mund të gjejnë aplikim për situatën financiare të subjektit para hyrjes në fuqi të tyre. Kërkesa, objekt gjykimi, referon në situatën financiare negative të palës së tretë, për një periudhë kur përcaktimet ligjore të sipërcituara, nuk kanë qenë në fuqi. Në vitet 2006 dhe 2007, pasqyrat e të cilave përbëjnë bazën e kërkesës së DRTT-së, kanë qenë në fuqi parashikimet e ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i cili nuk parashikonte të drejtën e organeve tatimore për të nisur procedurat e falimentimit të një subjekti me rezultat financiar negativ për tre vjet rresht.

Së dyti, në referim të parashikimeve të nenit 13 të ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008, “Për falimentimin”, për çeljen e një procedure falimentimi është e domosdoshme ekzistenca e shkakut:

13.1 Procedura e falimentimit hapet vetëm për shkak:

“2. Gjendja e paafësisë paguese përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit ...

4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit ...”.

Në nenin 14.1 të këtij ligji përcaktohet edhe rasti i kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit nga organet tatimore, **në rast se një subjekt rezultojnë me bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare**. Një parashikim i tillë, nuk mund të merret në mënyrë apriori nga ana e gjykatës, si shkak për hapjen e një procedure të tillë, nisur nga qëllimi i ligjit material specifik në këtë fushë. Qëllimi kryesor i kësaj procedure është shlyerja në mënyrë kolektive e detyrimeve të debitorit ndaj kreditorëve të tij, apo mbingarkesa me borxhe. Procesi i falimentimit në vetvete ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shlyerja e pasurive të tij do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani për shëndetësimin e subjektit, nëse konkludohet që një veprim i tillë është i mundur dhe më me interes se likuidimi i tij.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 18 të ligjit “Për falimentimin”, nga ana e gjykatës u procedua me thirrjen e ekspertës kontabël të regjistruar znj. Ana Osmani, për verifikimin e shkakut të hapjes së procedurës së falimentimit, verifikimin e faktit, nëse pasuritë e subjektit, mbulojnë shpenzimet e falimentimit etj. Nga ana e ekspertës, në cilësinë e administratorit të përkohshëm, u paraqit një raport mbi detyrat e lëna nga gjykata.

Në raportin e datës 19.7.2013, për hartimin e të cilit, për shkak të konflikteve ende të papërfunduara mes aksionarëve të shoqërisë, mungonin pasqyrat financiare të vitit 2012 dhe ajo e gjashtëmuajorit të parë e vitit 2013, është arritur në përfundimin se më datë 31.12.2011 **ka ekzistuar shkak real** për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV ALSAT” sh.a., pasi raporti i aktiveve me detyrimet ka qenë 1:1,49, pra, detyrimet kanë qenë 1,49 herë më të mëdha se aktivet e shoqërisë.

Po kështu, ekspertja, pas kryerjes së veprimeve të nevojshme në këtë fazë, ka arritur në përfundimin se është e pamundur të verifikohet nëse pasuritë e debitorit (palës së tretë) mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Gjatë gjykimit, në kushtet kur aksionarët e rinj të shoqërisë, në mbledhjen e datës 7.10.2013 miratuan pasqyrat financiare të shoqërisë dhe vendosën që kontributet e tyre të kalonin në kapitalin themeltar të shoqërisë, duke hequr dorë nga e drejta e kërimit të tyre, me qëllim rikonfirmimin e situatës së re financiare të shoqërisë, ekspertja iu la detyrë të verifikojë edhe njëherë, në bazë të provave të reja, kushtet e hapjes së procedurës së falimentimit të palës së tretë. Nga raporti i datës 24.1.2014 rezulton që ekspertja, pas këtij verifikimi, konfirmon se në referim të pasqyrave financiare të periudhës 2006–2012, detyrimet në shoqërinë “TV ALSAT” sh.a. (aktualisht “ALSAT” sh.a.), nuk tejkalojnë vlerën e aktiveve dhe shoqëria ka pasuri neto pozitive.

Mbështetur kryesisht në përfundimet e mësipërme të ekspertes, si dhe duke vlerësuar angazhimin e aksionarëve të rinj të shoqërisë, në drejtim të rregullimit të situatës financiare të shoqërisë, gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë duhet të rrëzohet për mungesë të shkakut të hapjes së procedurës së falimentimit në momentin e dhënies së vendimit.

Pasqyrimi nga ana e administratores së përkohshme të falimentimit në raportin e datës 24.1.2014, i një detyrimi të personit të tretë ndaj Shtetit për tatime dhe taksa, sigurime shoqërore dhe tatim-fitimi në shumën 120,472,999 lekë, **nuk mund të analizohet nga kjo Gjykatë, si shkak për hapjen e procedurës së falimentimit të këtij subjekti**, në kushtet kur legjislacioni i posaçëm tatimor përcakton mënyrën e komunikimit të këtij detyrimi subjektit, si dhe mënyrat e vjeljes së tij ...”.

- Pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), në parashtrimin e saj me shkrim dhe në konkluzionet përfundimtare, para disponimit me vendimin e ndërmjetëm për hapjen ose jo të procedurës së falimentimit (në rigjykim), evidenton faktin, se kundër vendimit nr. 2986, datë 3.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, **ka ushtruar të drejtën e ankimit vetë pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë**, në të cilin ka parashtruar se:

- Vendimi është i pambështetur në ligj dhe në prova dhe është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit.
- Shoqëria “ALSAT- TV” sh.a., e regjistruar si shoqëri nën administrimin e DRT Tatimore Tiranë, ka rezultuar me humbje për tre vjet të njëpasnjëshëm, konkretisht në vitet 2006, 2007, 2008.
- Në mbështetje të nenit 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, ka kërkuar në gjykatë çeljen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri.
- Me të drejtë, inspektori ka përcaktuar se kërkesa për çeljen e falimentimit është për periudhën 2007–2009.
- Kjo kërkesë është depozituar në gjykatë në shtator 2009, periudhë në të cilën qëndron shkak i kërkesës.
- Më tej, rezulton se me vendimin nr. 389, datë 16.2.2015, Gjykata e Apelit Tiranë (sot Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 2986, datë 3.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues ...”.

Në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 389/2015, ndër të tjerash, në shkallë të dytë është argumentuar se (citim i pjesës që konsiderohet si e nevojshme nga kjo Gjykatë **në rigjykim**):

“... Gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të shprehë mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, sipas nenit 6 të K. Pr. Civile; të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm, në përputhje me ligjin sipas nenit 14 të K. Pr. Civile; të zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj sipas nenit 16 të K. Pr. Civile, ndërsa në përputhje me përcaktimet e nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile duhet të bëjë një analizë tërësore dhe objektive të provave dhe të çmojë provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, sipas nenit 309 të po këtij Kodi.

Neni 28 i K. Pr. Civile shpreh, se: “Gjykata duhet të shprehë për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm”.

Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjor të tyre.

Gjykata e Apelit Tiranë, **ndryshe nga ç'ka konstatuar gjykata e shkallës së parë**, konstaton se në ankimin e saj pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nuk është dakord me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit, për sa kohë ajo pretendon se në mbështetje të nenit 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, ka kërkuar në gjykatë çeljen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri për periudhën 2007–2009. **Kjo kërkesë është depozituar në gjykatë në shtator 2009, periudhë në të cilën qëndronte shkaku i kërkesës.**

Gjithashtu, një pretendim tjetër i ngritur gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë ishte ai i Avokaturës së Shtetit, e cila, pretendon se gjatë gjykimit në shkallë të parë, gjykata nuk ia ka komunikuar aktet Avokaturës së Shtetit, si dhe nuk e ka njoftuar rregullisht për gjykimin, pretendim ky që bazohet në nenin 79/a të K. Pr. Civile. Gjykata nuk e ka njoftuar për asnjë seancë palën kërkuese.

Gjithashtu, një shkellje tjetër e konstatuar është fakti se gjykata e shkallës së parë është dhe caktimi i ekspertës Ana Osmani, e cila ka qenë e caktuar më parë si eksperte dhe nuk mund të caktohet përsëri edhe në kërkesën për faliment, pasi ajo nuk mund të kryejë detyrën edhe si kontabiliste dhe të marrë pjesë në falimentim. Pra, në përfundim të analizës së mësipërme, Gjykata e Apelit Tiranë çmon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i pambështetur në ligjin procedural, dhe për këtë arsye duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjyqësor ...”

- Sikundër është thënë pak më lart, në pjesën lidhur me rrethanat procedurale të këtij gjykimi, ka rezultuar se me vendimin nr. 1677, datë 6.7.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personi i interesuar në këtë gjykim, shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., kundër vendimit nr. 389, datë 16.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Në pjesën arsyetuese, për sa i përket zgjidhjes së çështjes në themel, ajo Gjykatë ka argumentuar se (citim i pjesës që konsiderohet si e nevojshme nga kjo Gjykatë **në rigjykim**):

“... Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se, në rekursin e paraqitur nga personi i interesuar në këtë gjykim, shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., kundër vendimit nr. 389, datë 16.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk janë paraqitur shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, të cilat ta bëjnë të cënueshëm këtë vendim.

12. Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit, të cilat kanë lidhje me plotësimin e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 472 të KPC-së, ky Kolegj konstaton, se: **i.** nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë, janë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor, apo të procedurës së gjykimit. Nuk rezulton, të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat, të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve; **ii.** nga aktet procedurale të gjykimit të zhvilluar, konstatohet se palëve in është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë, të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor; **iii.** nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë, janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e **ligjit material**. Kjo gjykatë ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; **iv.** në rastin objekt shqyrtimi konstatohet se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil, apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

13. Për sa më sipër, ky Kolegj, vlerëson se rekursi i paraqitur nga personi i interesuar në këtë gjykim, shoqëria “TV-ALSAT” sh.a, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së dhe për këtë arsye, nuk duhet të pranohet ...”.

B.iii. Shqyrtimi i kërkesës në rigjykim në vitin 2023, si dhe pretendimet e palës kërkuese DRT në rigjykim

Në rigjykim, pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), nëpërmjet përfaqësuesit të tij të legjitimuar, i shpjegoi Gjykatës, se **po këtë qëndrim në rigjykim ka mbajtur edhe Avokatura e**

Shtetit pranë Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë në pretendimet përfundimtare datë 28.12.2023, faqe 1–9:

- Kërkon që të mbahen parasysh **rrethanat e çështjes dhe historiku i këtij gjykimi**, faktin e provuar se shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. (aktualisht shoqëria “ALSAT” sh.a.) ka fituar personalitet juridik nëpërmjet vendimit nr. 24512, datë 11.9.2000, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si shoqëri anonime me objekt në fushën e veprimtarisë radiotelevizive, me aksionar kryesor shoqërinë “VeVe Grup” dhe shtetasin Vebi Velija, me kapital themeltar, fillimisht në shumën 2.000.000 lekë, i rritur në vitin 2002 në shumën 450.000.000 lekë, ndërsa në vitin 2004 është realizuar zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë në shumën 487.500.000 lekë.

Sipas palës kërkuese, në kushtet kur shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., e regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, me NIPT: K21407006R, **ka rezultuar me humbje për tre vjet të njëpasnjëshëm**, konkretisht, për vitet 2006, 2007 dhe 2008, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 11.9.2009 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën objekt shqyrtimi, duke kërkuar çeljen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a., në referim të dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, si dhe mbi parashikimin e nenit 104/pika “c” të ligjit “Për procedurat tatimore”.

Gjatë gjykimit të kësaj çështje janë hasur problematika midis aksionarëve të shoqërisë, të cilat janë krijuar si rezultat i vdekjes së aksionarit kryesor, të ndjerit Vebi Velija. Për këtë shkak, me vendim të ndërmjetëm të datës 26.10.2010 **është vendosur pezullimi i këtij gjykimi**, për shkak të gjykimit të çështjes së themelit mes aksionarëve të rinj të shoqërisë. Për këtë arsye, janë pezulluar të gjitha veprimet në QKR për këtë shoqëri deri në përfundim të gjykimit.

Pala kërkuese parashtron se gjykimi i kësaj çështjeje **ka rifilluar** pas rënies së shkakut të pezullimit në seancën gjyqësore të datës **20.9.2012 dhe** nga ekstrakti historik i shoqërisë, konfirmohen problematikat në lidhje me aksionarët e shoqërisë, situatë kjo e stabilizuar përfundimisht **më datë 27.6.2013**.

Në vijim, ka rezultuar se Asambleja e re e Aksionarëve të shoqërisë, me vendimin e datës 1.10.2013, ka vendosur: “*Miratimin e llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 1.1.2012 deri më 31.12.2012, ku shoqëria rezulton me humbje vjetore prej 30.413.514 lekësh. Miratimin e mosshpërndarjes së fitimit për faktin se shoqëria rezulton me humbje. Miratimin sipas kontratës për blerje aksionesh, datë 13.2.2013, të heqjes dorë të aksionarëve nga financimet e kryera në shoqëri, me vlerë 897.060.018 lekë, të cilat do të përdoren për mbulimin e humbjeve të mbartura me vlerë 926.115.593 lekë ...*”.

Këto fakte janë bërë objekt i kontrollit edhe nga ana e ekspertës së caktuar nga gjykata, nëpërmjet materialeve të përpiluara nga ana e saj në formën e raporteve mbi verifikimin e kushteve të falimentimit të personit të tretë.

- Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Blerina Muça, me vendimin nr. 2986, datë 3.3.2014, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës së kërkesit Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese ...*”.

Pala kërkuese DRT, në parashtrimin e saj, në kuadër të këtij procesi (**në rigjykim**) i referohet vendimit të përmendur nr. 2986/2014, duke evidentuar edhe përmbajtjen e këtij vendimi dhe të atij të Gjykatës së Apelit (*citim nga vetë pala kërkuese i vendimit nr. 2986/2014 në shkallë të parë dhe i vendimit nr. 389/2015 në shkallë të dytë, të cituar pak më lart*).

- Në kuadër të shqyrtimit të çështjes (**në rigjykim**) dhe në lidhje me zgjidhjen e çështjes në themel, pala kërkuese ka parashtruar se Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 11.9.2009, ka investuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për çeljen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a., në referim të dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, si dhe mbi parashikimin e nenit 104/pika “c” të ligjit “Për procedurat tatimore”, duke pretenduar se pala e tretë, e cila është e regjistruar në DRTT me NIPT: K21407006R, ka rezultuar me humbje për tre vjet radhazi të njëpasnjëshëm, konkretisht, **për vitet 2006, 2007 dhe 2008**.

Mbështetur në nenin 104/1/“c” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në

RSH”, dhe në nenin 14/1 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, ky organ publik, referuar konstatimeve mbi shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a., ka deklaruar se humbjet e kësaj shoqërie kanë konsistuar në 3 (tre) vjet radhazi të njëpasnjëshëm, konkretisht, vitet 2006–2007–2008 dhe se provat mbi të cilat DRT-ja është mbështetur janë **vetë bilancet e depozituara nga kjo shoqëri**. Të tilla procedura për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës.

Referuar kërkesës objekt gjykimi, sipas palës kërkuese, vlerësohet se e drejta e palës kërkuese për t’iu drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt hapjeje të procedurës së falimentimit gjen mbështetje në nenin 104/pika “c” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon se: *“Fillimi i procedurës së falimentimit në gjykatë nga administrata tatimore bëhet në përputhje me ligjin për falimentimin”*, ku ky i fundit në nenin 14/1 të ligjit “Për falimentimin”, parashikon, se: *“Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezultojnë një bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare”*.

Në vijim, pala kërkuese referon në nenin 14 të ligjit “Për falimentimin”, ku përcaktohet shprehimisht dokumentacioni i kërkuar nga ligji që duhet t’i bashkohet kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, në rastin kur kërkesa parashtrohet **nga organi tatimor**, sikundër është rasti konkret. Më konkretisht, pala kërkuese citon nenin 14.1/2 të ligjit, ku thuhet se:

“1/2. Organet tatimore përjashtohen nga pagimi i taksave gjyqësore. Për fillimin e procedurës së falimentimit organet tatimore paraqesin në gjykatë:

- a) Kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit;*
- b) Dokumentacionin e shoqërisë (statutin, aktin e themelimit, numrin e NIPT-it);*
- c) Bilancin me pasqyrat financiare të shoqërisë, për të cilën kërkohet fillimi i procedurës së falimentimit.”*

- Sipas palës kërkuese, në rastin objekt gjykimi, bashkë me kërkesën për hapje të procedurës së falimentimit, është sjellë në gjykatë midis të tjerave dhe i gjithë dokumentacioni çfarë kërkohet në nenin 14 të ligjit: - *Pasqyrat financiare dhe bilancet e shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. , për vitet 2006, 2007 dhe 2008, ku në këto pasqyra financiare jepen pasuritë (inventarët e ndryshëm), përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra të debive dhe kredive etj.*

Pala kërkuese, në tërësinë e dokumenteve të paraqitura, ashtu sikundër ka parashtruar në shpjegimet e saj, ka pretenduar se i plotëson kërkesat e ligjit “Për falimentimin”, **duke parashtruar si shkak për hapjen e kësaj procedure faktin se personi i tretë ka rezultuar në mënyrë të pandërprerë me një bilanc ekonomik me humbje për më shumë se tre vjet radhazi**.

Një fakt i tillë, sipas palës kërkuese, dikton pamundësinë e personit të tretë për të marrë pjesë në vazhdim në qarkullimin civil si subjekt tregtar, kjo edhe për shkak të cenimit të interesave të ligjshëm të kreditorëve eventuale të kësaj shoqërie, e mbi të gjitha shtetit. Ndër shkaqet për hapjen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri tregtare, *veç humbjeve në vijimësi*, është edhe *gjendja e paaftësisë paguese* të personit për të gjithë ortakët dhe të tretë.

Kjo gjendje e paaftësisë paguese, nga pikëpamja e ligjit mbi falimentin, përbën një shkak të përgjithshëm dhe me të ligji lidh një nga mundësitë potencialisht të mjaftueshme për hapjen e procedurës së falimentimit.

Sipas palës kërkuese, në mbështetje të provave të administruara në dosjen gjyqësore vlerëson se shoqëria ka rezultuar përgjatë tre vjetëve në kushtet si vijon (*faqet 7–8 të parashtrimit me shkrim*):

viti 2006 me të ardhura 71,929,195 lekë/shpenzime (-)189,110,994 lekë/ *humbje* (-) 117,181,799 lekë
viti 2007 me të ardhura 33,797,716 lekë/shpenzime (-)115,798,997 lekë/ *humbje* (-)114,766,562 lekë
viti 2008 me të ardhura 38,705,206 lekë/shpenzime (-)111,765,651 lekë/ *humbje* (-) 75,051,445 lekë
TOTALI humbje (-) 304,999,806 lekë

- Sipas palës kërkuese, të dhënat tregojnë se **më datë 11.9.2009, momenti kur është depozituar kërkesa objekt gjykimi, ka ekzistuar shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit**, pra, mund të vlerësohet që shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. nuk ka pasur mundësi për të gjeneruar të ardhura që mund të përmirësojnë treguesit e saj ekonomikë apo që të mund të kishte aftësinë paguese të saj,

thënë kjo realisht, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka çmuar se ekziston shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit, pasi vazhdimi i aktivitetit tregtar nga ana e shoqërisë është pothuajse i pamundur.

Më tej, pala kërkuese parashtron dhe argumenton se në këtë rast ekziston shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit, sepse (f. 8 e parashtrimit me shkrim):

1. Shoqëria rezulton me humbje për 3 vjet dhe në vitin 2008 kjo humbje rezulton të jetë 75.051.445 lekë, referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 104, “Fillimi i procedurave të falimentimit”, pika 1/“c”, e cila thotë: *“Administrata tatimore kërkon në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit, shoqëri tregtare: që deklarojnë rezultat me humbje të kapitaleve të veta për të paktën 3 vjet rresht.”*

2. Shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., në këtë rast, është në gjendjen e paafësisë paguese për detyrimet e njohura prej tij ndaj kreditorëve (referuar bilancit dhe dokumenteve të dorëzuara në gjykatë).

3. Shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., në këtë rast, nuk i ka përmbushur në kohë detyrimet (referuar bilancit dhe dokumenteve të dorëzuara në gjykatë).

Sipas palës kërkuese, po këtu duhet të mbahet parasysh edhe fakti që shoqëria nuk ka publikuar pasqyra të tjera të mëvonshme pas vitit 2014.

- Gjithashtu, pala kërkuese DRT ka evidentuar në parashtrimin e saj me shkrim (faqe 8–9), se rrethanat ligjore të pretenduara janë provuar edhe me anë të **aktekspertimit kontabël të bërë nga ekspertja/audituesja ligjore Shpresa Breçani**, e cila në përgjigjen e saj në kërkesë të pyetjeve të bëra nga gjykata është shprehur se:

“... 1. Për sa më sipër shoqëria nuk disponon likuiditete për shlyerjen e detyrimeve të papaguara të evidentuara sipas informacionit të dërguar nga kreditori Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, DPTTV Bashkia Tiranë, si dhe institucionet financiare.

Shoqëria “ALSAT” sh.a. është e mbingarkuar me detyrime të papaguara, ndodhet në kushtet e paafësisë paguese, bazuar në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”, neni 14 i tij, ekzistojnë kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALSAT” sh.a.

2. Ekzistenca e pasurisë së paluajtshme në emër të shoqërisë “ALSAT” sh.a., konkretisht e pasurisë e llojit truall dhe ndërtesë, me vendndodhje në qytetin e Tiranës, sipas shkresës nr. 5216/3 prot., datë 2.10.2023, të dërguar nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, është më se e mjaftueshme për të mbuluar kostot e procedurës së falimentimit, pavarësisht se nuk disponojmë vlerën aktuale të kësaj pasurie.

Në këto kushte, debitori ka mundësi të mbulojë shpenzimet e procedurës së falimentimit.

3. Bazuar në informacionin e ndodhur në dosjen gjyqësore, konkretisht shkresa nr. 5216/3 prot., datë 2.10.2023, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton se në emër të debitorit shoqërisë “ALSAT” sh.a. është pasuria me nr. 8/578, volumni 18, zona kadastrale 8340, e llojit truall, me sipërfaqe 1626 m², nga të cilat 1626 m² truall dhe ndërtesë 933.3 m².

Mbi këtë pasuri janë vendosur kufizime të tipit sekuestro konservative nga studio përmbarrimore ALBAS, edhe përmbarruesi privat Ermir Godaj, të pasqyruara edhe në kartelën e pasurisë sesioni D. Kjo pasuri është pjesë në masën e falimentit në kuptim të ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”, për këtë shkak vlerëson se është e nevojshme të vendoset një masë e përkohshme nga Gjykata, me qëllim që të parandalohet dhe të ndërpritet transferimi i pronësisë së kësaj pasurie te personat e tretë ...”.

- Sipas palës kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), referuar informacionit të dërguar nga RBS (Regjistri i Barrëve Siguruese) me kthim përgjigjen nr. 3026/1 prot., datë 12.6.2023, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga Regjistri i Barrëve Siguruese, rezulton se në emër të shoqërisë “ALSAT” sh.a. janë vendosur **2 (dy)** urdhra bllokimi më datë **8.6.2023 nga SGA s.p.a. dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë** dhe vlerëson se është e nevojshme të vendoset një masë e përkohshme nga Gjykata, me qëllim që të parandalohet dhe të ndërpritet transferimi i pronësisë te personat e tretë

Duke qenë se janë në fuqi disa urdhra përmbarrimorë, të cilët mund të shtohen në të ardhmen, bazuar kjo në situatën financiare të debitorit, vlerësoj se rreziku i pasurive është i lartë (por pa evidentuar ndonjë pasuri konkrete, sikundër e ka shpjeguar ekspertja/ administratorja e falimentit në seancën gjyqësore pas

pyetjeve plotësuese të gjykatës).

- Në përfundim të kësaj faze të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri, pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), ka pretenduar se, në këtë rast, është e nevojshme vendosja e **masave të përkohshme, me qëllim sigurimin e pasurive të debitorit, shoqërisë “ALSAT” sh.a.** Marrja e një mase të tillë është në interes të kreditorëve, për sa i përket situatës aktuale në të cilën ndodhet debitori.

Si konkluzion, duke iu referuar fakteve të parashtruara më sipër, provave dhe interpretimit të ligjit, ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në lidhje me këtë rast, të një personi juridik privat: **“Pranimin e kërkesës së ngritur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë si të bazuar në ligje në prova” (f. 9 e parashtrimit me shkrim në konkluzionet përfundimtare).**

B.iv. *Shqyrtimi i kërkesës në rigjykim në vitin 2023, hetimi gjyqësor për kushtet ligjore lidhur me hapjen e procedurës së falimentimit, provat shkresore të marra kryesisht dhe ekspertimi kontabël i ekspertës/administratores së falimentit*

- **Në rigjykim**, nga ana e kësaj Gjykate është bërë një hetim gjyqësor i plotë e i gjithanshëm (nenet 14, 29, 2233-224, 177/1 të K. Pr. Civile) lidhur me gjendjen financiare dhe me aktivet/pasuritë e luajtshme e të paluajtshme/mjetet monetare të shoqërisë “ALSAT” sh.a. (më parë shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., duke marrë informacion me shkrim: *i.* nga të gjitha Drejtoritë vendore të agjencisë shtetërore të kadastrës (ASHK); *ii.* nga të gjitha bankat e nivelit të dytë; *iii.* nga Autoriteti Portual Durrës; *iv.* nga Regjistri i Barrëve Siguruese; *v.* nga organet e administratës tatimore (pasqyrat financiare dhe bilancet që janë dorëzuar dhe të dhënat mbi detyrimet e subjektit); *vi.* nga organet e administratës doganore etj.

Në kuadër të këtij procesi të gjitha këto akte janë relatuar në seancë gjyqësore, është disponuar për lejimin e shqyrtimin e tyre **si prova shkresore**, i janë nënshtruar debatit gjyqësor duke iu vënë palëve në dispozicion, si dhe janë marrë parasysh nga ana e ekspertës/administratores së falimentit Shpresa Breçani, duke u pasqyruar hollësisht në raportin e ekspertimit kontabël.

- Po kështu, **në rigjykim**, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuarit, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), për ekzistencën e gjendjes së falimentimit të shoqërisë “ALSAT” sh.a. (më parë shoqëria “TV-ALSAT” sh.a.), në zbatim të nenit 18 të ligjit të posaçëm nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, nga ana e kësaj Gjykate është disponuar për caktimin **si eksperte dhe si administratore të përkohshme** të falimentimit ekspertin/administratoren Shpresa Breçani, së cilës iu caktuan si detyra të tilla (tipike në këtë procedurë), si: **i.** të verifikojë ekzistencën e shkakut/shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, në drejtim të gjendjes së paaftësisë paguese të subjektit apo/ dhe mbingarkesës së tij me borxhe; **ii.** të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit; **iii.** dhënien e një opinionit për të mbikëqyrur veprimtarinë e debitorit, si dhe mundësinë për vijimësinë e veprimtarisë tregtare të debitorit; **iv.** për të dhënë një opinion, nëse është e nevojshme që të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë e shoqërisë.

Nga **raporti nr. 8050 prot., datë 3.11.2023** (numri dhe data e protokollit sipas të dhënave në momentin e depozitimit në kryesekretari) i paraqitur nga ekspertja/administratoresja e përkohshme e falimentimit u përshkrua, se:

“... Referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, konkretisht pasqyrat financiare për vitin 2014 të shoqërisë “ALSAT” sh.a., në të cilat ka informacion për periudhën 2013–2014. Në dosjen gjyqësore nuk janë depozituar raportet e auditimit të këtyre pasqyrave dhe nuk ka informacion nëse këto pasqyra janë të auditura. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk ndodhen pasqyrat dhe dokumentacioni financiar pas vitit 2014 ...”

Konkluzion i analizës financiare

Referuar pasqyrave financiare 2014, të cilat janë pasqyrat e fundit të deklaruara në organin tatimor nga shoqëria “ALSAT” sh.a., nuk mund të merren në konsideratë për analizimin e gjendjes së paaftësisë aktuale të shoqërisë. Bazuar në kërkesat e ligjit për falimentimin, në nenin 14/pika 1/ “c” është kusht për vlerësimin e paaftësisë paguese ekzistuese dhe në një të ardhme të afërt të debitorit që të analizohen treguesit financiarë të tre vjetëve të fundit. Në mungesë të pasqyrave financiare të tre vjetëve të fundit dhe konkretisht të viteve 2020, 2021, 2022, nuk mund të dalë në një

*konkluzion mbi paaftësinë paguese aktuale të debitorit (d.m.th. nuk ka një konkluzion prej ekspertës/ administratores së falimentit lidhur me paaftësinë paguese të debitorit – **konstatim i gjykatës**) ...*

*Bazuar në dosjen gjyqësore nuk ka informacion tjetër përveç informacionit të marrë nga pasqyrat financiare të vitit 2014. Duke qenë se informacioni në këto pasqyra është shumë i hershëm, nga ana ime i është kërkuar Gjykatës marrja e informacionit nga institucionet shtetërore përkatëse, nëse disponohet aktualisht pasuri në emër të shoqërisë “ALSAT” sh.a. (d.m.th. nuk ka dokumentacion tjetër përveç pasqyrave financiare të vitit 2014 për të konkluduar prej ekspertës/ administratores së falimentit lidhur me paaftësinë paguese të debitorit – **konstatim i gjykatës**) ...*

*Sipas shkresës nr. 5216/3 prot., datë 2.10.2023 drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga Drejtoria Vendore ASHK Tiranë Veri, rezulton se në emër të shoqërisë “ALSAT” sh.a. të jetë e regjistruar pasuria e paluajtshme me të dhëna si më poshtë vijon: **Pasuria paluajtshme me nr. pasurie 8/578, ZK 8340, volumi 18, faqe 60, indeks harte TR-K11, e llojit truall me sipërfaqe 1626 m² dhe ndërtesë 933.3 m² ...***

Referuar sesionit D të kartelës së pasurisë së paluajtshme rezulton se mbi pasurinë e paluajtshme janë vendosur 4 urdhra bllokimi të vendosur, përkatësisht në datat 26.2.2016, datë 17.2.2018, datë 2.8.2022 dhe më datë 28.3.2023...

2.2 Pasuritë e luajtshme

*Bazuar në shkresën nr. 3026/1 prot., datë 12.6.2023, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga Regjistri i Barrëve Siguruese rezulton se në emër të shoqërisë “ALSAT” sh.a. janë vendosur 2 urdhra bllokimi më datë 8.6.2023 nga **SGA s.p.a** dhe nga **Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë**, por nga informacioni i dërguar nuk identifikohen se cilat janë këto pasuri të luajtshme dhe vlerat përkatëse të tyre (d.m.th. nuk ka pasuri të luajtshme të identifikuar në emër të kësaj shoqërie, të cilat mund të ishin pjesë e përllogaritjeve nga ana e ekspertës/ administratores së falimentit dhe ndaj të cilave mund të vendosej masa e sekuestros/ bllokimit – **konstatim i gjykatës**) ...*

2.3 Mjetet monetare dhe likuiditete

Për sa iu përket llogarive rrjedhëse në banka, garancitë reale dhe/ ose personat e depozita ose peng etj., nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është kërkuar në rrugë zyrtare nëpërmjet shërbimit postar informacion nga bankat e nivelit të dytë, në total 12 banka që operojnë në Shqipëri sipas të dhënave të mëposhtme ...

*Nga informacionet e marra nga bankat nuk rezulton gjendje likuiditetesh. Gjithashtu, pjesa më e madhe e llogarive bankare në bankat ku shoqëria ka pasur llogari janë me statusin “të mbyllura” (d.m.th. nuk ka mjete monetare dhe likuiditete në emër të kësaj shoqërie, të cilat mund të ishin pjesë e përllogaritjeve nga ana e ekspertës/ administratores së falimentit dhe ndaj të cilave mund të vendosej masa e sekuestros/ bllokimit – **konstatim i gjykatës**) ...*

Konkluzioni i pasurive në pronësi të shoqërisë

Referuar kthimit të përgjigjeve nga ana e institucioneve shtetërore kolaudojmë se shoqëria “ALSAT” sh.a. aktualisht disponon:

- Pasuri të paluajtshme me nr. pasurie 8/578, ZK 8340, volumi 18, faqe 60, indeks harte TR-K11, e llojit truall me sipërfaqe 1626 m² dhe ndërtesë 933.3m² me vendndodhje në Tiranë.

- Pasuri të luajtshme sipas regjistrat të RBS-së, të cilat nuk janë të identifikuar në informacionin e vënë në dispozicion nga RBS-ja me shkresën nr. 3026/1 prot., datë 12.6.2023 ...

Referuar procesit gjyqësor dhe kërkesës për çeljen e procedurës së falimentimit është iniciuar nga kreditori, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

*Me shkresën nr. 26149/1 prot., datë 12.6.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, rajoni qendror informon Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vlerën e detyrimeve tatimore të papaguara deri më datë **12.6.2023, shumë në vlerën 331,630,567 lekë.***

*Gjithashtu, mbas kërkesës për informacion të kërkuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. 110722/1 prot., datë 19.6.2023, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë ka kthyer përgjigje dhe nga informacioni i dërguar rezulton se subjekti “ALSAT” sh.a. ka detyrime të papaguara në total në vlerën **1,000,772,0 lekë për periudhën 2015–2023 ...***

Për sa më sipër sqaruar, shoqëria nuk disponon likuiditet për shlyerjen e detyrimeve të papaguara të evidentuara sipas informacionit të dërguar nga kreditori Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, DPTTV Bashkia Tiranë, si dhe institucionet financiare.

Konkludojmë se: **shoqëria “ALSAT” sh.a. e mbingarkuar me detyrime të papaguara, ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese**, bazuar në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”, nenin 14 të tij, ekzistojnë kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALSAT” sh.a....

Për sa relatuar më lart, ekzistenca e pasurisë së paluajtshme në emër të shoqërisë “ALSAT” sh.a., konkretisht e pasurisë e llojit truall dhe ndërtesë, me vendndodhje në qytetin e Tiranës, sipas shkresës nr. 5216/3 prot., datë 2.10.2023 të dërguar nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri, është më se e mjaftueshme për të mbuluar **kostot e procedurës së falimentimit**, pavarësisht se nuk disponojmë vlerën aktuale të kësaj pasurie.

Në këto kushte, debitori ka mundësi të mbulojë shpenzimet e procedurës së falimentimit ...

Referuar ekstraktit të QKB-së rezulton se statusi i shoqërisë është aktiv. Në ekstraktin historik të shoqërisë nuk është i pasqyruar dokumentacioni ekonomik-financiar sipas ligjit të QKB-së.

Sipas informacionit të dërguar nga administrata tatimore shoqëria “ALSAT” sh.a. ka statusin pasiv nga datë 20.6.2020 dhe nuk ka deklaruar dhe depozituar pasqyra financiare pas vitit 2014.

Nga informacionet e përmendura sa më lart, nuk është pasqyruar aktiviteti i shoqërisë debitore për të dhënë një vlerësim mbi aktivitetin dhe vazhdimësinë e veprimtarisë.

Në këto kushte, nuk mundet të paraqesë një opinion mbi mbikëqyrjen e veprimtarisë së debitorit (d.m.th. nuk ka një konkluzion prej ekspertës/administratores së falimentit lidhur me mundësinë e vijimit të veprimtarisë së shoqërisë-**konstatim i gjykatës**) ...

Duke qenë se janë në fuqi disa urdhra përmbarimorë, të cilët mund të shtohen në të ardhmen bazuar kjo në situatën financiare të debitorit, vlerësoj se rreziku i ekzekutimit të pasurive është i lartë.

Si rrjedhojë, **gjykoj të nevojshme vendosjen e masave të përkohshme**, me qëllim sigurimin e pasurive të debitorit, shoqërisë “ALSAT” sh.a., marrja e një mase të tillë është në interes të kreditorëve, për sa i përket situatës aktuale në të cilën ndodhet Debitori ...

- Ndërkohë, në seancën gjyqësore të datës 22.12.2023, mbi pyetjet e Gjykatës referuar raportit të sipërcituar, nga ana e ekspertës/administratores së falimentit Shpresa Breçani janë dhënë **këto përgjigje plotësuese dhe sqaruese**, duke deklaruar se:

“... Në lidhje me konkluzionin tuaj në raport ju konfirmoj që pala e tretë shoqëria “ALSAT” është me mbiborxhe?

Ekspertja: - Po e konfirmoj, nuk ka likuiditete për të shlyer detyrimet, **ka paaftësi për të paguar dhe mbingarkesë në borxhe**. Kërkesa e kreditorit për mendimin tim është e bazuar në ligj. Jemi para paaftësisë paguese dhe mbingarkesës në borxhe, pra, sipas nenit 14 ekzistojnë kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit ...

Sipas mendimit tim, mbulohen shpenzimet për procedurën e falimentimit ...

Sot statusi i shoqërisë është aktiv. Dua t’i them gjykatës se kjo pasuri e paluajtshme ka edhe urdhra përmbarimorë bllokimi, të cilët unë i kam relatuar në raport ... janë vetëm urdhra përmbarimorë nga tatimet dhe SGA-ja. Nuk ka të dhëna për pasuri të luajtshme ekzistuese ...

Unë mendoj, si rrjedhojë e gjyqimit, **vendosjen e masës së përkohshme** ndaj shoqërisë “ALSAT” sh.a., masë e cila është në interes të kreditorëve.

Sugjeroj hapjen e procedurës së falimentit”.

C. **Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, si dhe në lidhje me rrethanat e çështjes e mbi kërkimin për të miratuar ose jo hapjen e procedurës së falimentit për shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.)**

- Mbi ligjshmërinë e kërtimeve të paditësit/kërkuesit/ankuesit (sipas rastit, këtu “kërkues”) Gjykata i referohet **nenit 16/1** të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, për zgjidhjen drejt të çështjes, ajo iu referohet të gjitha dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, që janë të detyrueshme për të duke iu bërë fakteve e rrethanave një cilësim sipas bindjes së saj të brendshme, pa u lidhur me përcaktimin që bëjnë palët ndërgjyqëse.

Konkretisht, kjo dispozitë përcakton, se: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës.”.

Po kështu, Gjykata mban parasysh edhe **nenin 6** të po këtij Kodi që parashikon, se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehë mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.”.

Në këtë kuptim, Gjykata duke iu referuar **nenit 17** të Kodit të Procedurës Civile orienton palën paditëse/kërkuese/ankuese duke e ftuar atë të japë shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pikërisht, për dispozitat civile materiale (*ligji nr. 8901/2002, “Për falimentimin”; K. Pr. Civile*), ku kjo palë mbështet kërkimet e saj.

Ndërsa në **nenin 28** të Kodit të Procedurës Civile parashikohet, se: “Gjykata duhet të shprehë për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”.

Në kuptim të këtyre dispozitave, në ushtrimin e veprimtarisë së saj Gjykata udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe iu krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor mbi parimin e kontradiktoritetit dhe debatit gjyqësor midis palëve për faktet, provat, pretendimet e prapësimet ligjore (nenet 15, 18, 19, 20 të Kodit).

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, Gjykata vlerëson se në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ajo (gjykata) paraqitet në rolin e një arbitri asnjansës, i cili vlerëson në mënyrë të paanshme pretendimet e palëve dhe në fund i shpall ato të bazuara apo jo. Palët kanë të drejtë të parashtrijnë para gjykatës interpretimin apo përcaktimin e tyre për faktet dhe të drejtat që lidhen me zgjidhjen e çështjes, por gjykata, në ushtrim të pavarësisë dhe paanësisë së saj, i çmon vetë këto çështje, e nëse i gjen të bazuara pretendimet e palëve i pranon, në të kundërt i rrëzon ato.

Parimi “*iura novit curia*” në këtë rast do të thotë se gjykata nuk i merr si të mirëqena shpjegimet e palëve në lidhje me zbatimin e ligjit për çështjen konkrete, por, si njohëse e ligjit, e zgjidh vetë mosmarrëveshjen, sipas formimit dhe bindjes së saj të brendshme, të bazuar në kriteret që parashikon Kushtetuta, Kodi i Procedurës Civile dhe ligjet e veçanta (*sipas rastit, këtu dispozitat e ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar*).

- Në këto kushte, duke ballafaquar situatën faktike të përmendur më sipër me legjislacionin tonë civil në fuqi në RSH, Gjykata analizon se:

Së pari, në lidhje me bazueshmërinë e kësaj kërkesë, Gjykata çmon të nevojshme që të ndalet dhe të argumentojë se për cilat arsye, në këtë rast, ***lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes*** (ku përfshihen aspekte, si: legjitimitimi apo jo i palës kërkuese, DRT-ja, si organ i administratës tatimore; analiza për situatat dhe për kushtet se kur mund të hapet procedura e falimentimit etj.) do të zbatohen dispozitat e **ligjit nr. 8901/2002**, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, duke vlerësuar se pikërisht **ky është ligji i zbatueshëm** në rastin konkret.

Kjo, duke qenë ky akt, *ligji i posaçëm në fuqi në momentin e depozitimit të kërkesës* nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRT) si palë kërkuese, çështje e cila ka kaluar në të tria shkallët e gjykimit, sikundër është thënë në pjesën e rrethanave procedurale të çështjes.

- Si fillim, në lidhje me çështjen e ligjit të zbatueshëm për shqyrtimin e kërkesës objekt gjykimi, kjo Gjykatë e konsideron të nevojshme që të citojë **dispozitat kalimtare të ligjit të ri** me nr. 110/2016, “Për falimentimin”, ku janë përcaktuar rregulla të qarta se për cilat çështje që lidhen me procedurat e falimentimit do të jetë i zbatueshëm **ligji i ri** me nr. 110/2016 dhe për cilat çështje do të jetë i zbatueshëm **ligji i mëparshëm** me nr. 8901/2002, i ndryshuar.

Këto dispozita kalimtare përcaktojnë zbatueshmërinë e ligjit të ri, si *për aspektin material* të tij (kushtet kur hapet procedura e falimentimit; subjektet që mund të kërkojnë hapjen e procedurës etj.), ashtu edhe *për aspektin procedural* (rregullat formale për paraqitjen e kërkesës, dokumentacioni shoqërues, marrja e dokumentacionit për hetim shterues, emërimi i administratorit, masat e sigurimit, plani i riorganizimit etj. etj.).

Këtu mbahet parasysh se, të dyja këto ligje të posaçme që rregullojnë procedurën e falimentimit (ligji nr. 8901/2002 dhe ligji nr. 110/2016) kanë **natyrë mikse**, me elemente *materiale* dhe *procedurale*, sikundër do të trajtohet pak më poshtë.

Kështu, në nenet 209-210-211 të ligjit nr. 110/2016 është përcaktuar se:

“PJESA E NJËMBËDHJETË DISPOZITA KALIMTARE

Neni 209

Dispozita kalimtare

1. Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, shfuqizohet.
2. Neni 104, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohet.
3. Të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen për sa kohë nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.
4. Këshilli i Ministrave miraton, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 210

Procedurat në vazhdim

Ky ligj nuk ka fuqi prapavepruese dhe rregullon vetëm procedurat e nisura pas hyrjes së tij në fuqi.

Neni 211

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.”.

Pra, duke parë momentin e hyrjes në fuqi, në aspektin e zbatueshmërisë **për anën materiale** të normave të tij (kushtet kur hapet procedura e falimentimit; subjektet që mund të kërkojnë hapjen e procedurës etj.) ligji i ri **nuk përfshin** ato çështje që janë regjistruar dhe kanë nisur **para hyrjes** në fuqi të tij, sikundër është çështja objekt gjykimi e depozituar në kryesekretari më datë 11.9.2009 (pavarësisht se vendimi i gjykatës së shkallës së parë me nr. 2986/2014 është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim, kjo **vetëm për aspektin procedural**, sipas Kodit të Procedurës Civile, neni 467 i tij, në lidhje edhe me dispozitat e ligjit nr. 38/2017, që kanë bërë ndryshime thelbësore për gjykimin e zakonshëm civil në shkallë të parë, siç do të trajtohet pak më poshtë).

- Për këtë vlerësim (d.m.th. për të përcaktuar ligjin e zbatueshëm), kjo Gjykatë mban parasysh **momentin e depozitimit** të kësaj kërke, si dhe **natyrën e ligjit të posaçëm** që parashikon rregullat për zhvillimin e procedurës së falimentit, ligj që nga përmbajtja në tërësinë e tij del se ka një **natyrë mikse**, d.m.th. është një ligj me dispozita të natyrës *materiale* dhe *procedurale*, qoftë *ligji nr. 8901/2002* që ishte në fuqi në momentin e depozitimit të kësaj kërke më datë 11.9.2009, qoftë *ligji nr. 110/2016* që është në fuqi në momentin e shqyrtimit të kësaj kërke pas kthimit të çështjes për rigjykim në vitin 2023 (*ligje të cilat, në thelb, nuk kanë ndryshime të dukshme dhe as klanzola të caktuara e të ndryshme për rrethanat e zbatimit të tyre*).

Gjykata arrin në këtë përfundim, duke qenë se ligji “Për falimentin” (ligji nr. 8901/2002 dhe ligji nr. 110/2016) parashikon jo vetëm rregullat për hapjen, për zhvillimin dhe për mbylljen e procedurës së falimentit, apo edhe gjykatën kompetente të seksionit tregtar dhe veprimet e kësaj të fundit në kuadër të gjithë kësaj procedure të detajuar, me funksione tradicionale gjyqësore dhe me funksione specifike administrimi dhe mbikëqyrje (*dispozita këto që i japin natyrën **procedurale** këtij ligji*), por edhe kushtet dhe kriteret se kur gjykata mund të vlerësojë se janë rrethanat për hapjen-zhvillimin-mbylljen

e procedurës së falimentit dhe rregulla për subjektet që mund të nisin një procedurë të tillë (*dispozita këto që i japin natyrën materiale këtij ligji*).

Madje, edhe në doktrinë (shih: **i.** - E drejta e falimentimit në Shqipëri, Material për seminar, Shkolla e Magjistraturës dhe USAID-i, botim i vitit 2013, f. 25, në lidhje edhe me trajtimin që është bërë në f. 22, 26, 56–58, 90-91; **ii.** - Paaftësia paguese dhe falimentimi, Shkolla e Magjistraturës, dhjetor 2013; **iii.** - Hyrje në sistemin shqiptar të falimentimit, IFC Albania, botim grup autorësh) është trajtuar dhe pranuar se ligji “Për falimentimin”, është me natyrë mikse, por në pjesën më të madhe të tij, përbëhet nga norma materiale që kanë efekt mbi të drejtat dhe parashikojnë detyrime për kategori të ndryshme personash, në varësi të pozicionit të tyre.

Ndërkohë, duke pasur parasysh **veprimtarinë e gjykatës dhe funksionet** që kryen Gjykata e Falimentimit në një procedurë të tillë (shqyrtimi i kërkesës për hapjen ose jo të procedurës dhe dalja me vendim; zhvillimi i kësaj procedure me veprime procedurale dhe administrative; mbyllja e kësaj procedure me vendim) qartësohet edhe funksioni i gjykatës (funksioni tradicional vendimmarrës dhe funksioni për kryerjen e hetimit gjyqësor, në kuadër të kësaj vendimmarrjeje; funksioni i administrimit dhe mbikëqyrjes së kësaj procedure), dispozita që e bëjnë ligjin “Për falimentimin” dhe i japin **natyrën procedurale** (qoftë ligji nr. 8901/2002, qoftë ligji nr. 110/2016). **Është e qartë se në një procedurë falimentimi, pikërisht, nisur nga këto funksione, gjykata ka një rol më aktiv se sa pozicioni i saj klasik në një gjykim të zakonshëm**, sipas rregullave procedurale civile (vendimmarrja për hapjen e procedurës; veprimet procedurale dhe administrative për mbikëqyrjen e kësaj procedure deri në përfundim; vendimmarrja për mbylljen e procedurës së falimentimit).

Madje, ushtrimi i funksionit të vendimmarrjes gjyqësore, edhe në këtë rast dhe në këtë procedurë, nënkupton që Gjykata e Falimentimit të përgatitet dhe të dëgjojë pretendimet e të gjitha palëve që ligji ua njeh të drejtën të njoftohen e të jenë të pranishme në këtë proces, të marrë prova shkresore dhe të disponojë për një ekspertim kontabël, të disponojë për marrjen e masave të sigurimit, të emërojë dhe të shkarkojë administratorin etj., si dhe në fund të japë një vendim gjyqësor të ankimueshëm.

- Po kështu, duke iu referuar datës së paraqitjes së kërkesës në kryesekretari (kërkesa është paraqitur fillimisht më datë 11.9.2009, kurse pas kthimit për rigjykim është regjistruar më datë 27.9.2022, çështja e shortuar i ka kaluar gjyqtarit më datë 10.2.2023), në raport me datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin procedural civil që përcaktojnë (*së fundmi*) rregullat e gjykimit të zakonshëm në shkallë të parë, konkretisht, të ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, rezulton se (pas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 389/2014 për kthimin e çështjes për rigjykim) kërkesa e regjistruar **në shtator 2022** dhe që i ka kaluar (më pas) këtij trupi gjykues mban **një datë të mëvonshme** në kohë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 38/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, ‘Kodi i Procedurës Civile në RSH’”, të ndryshuar, duke qenë se këto ndryshime kanë hyrë në fuqi **më datë 5.11.2017**.

Konkretisht, sipas nenit 111 të ligjit nr. 38/2017, ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa rezulton se ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98, viti 2017, ditën e premte më datë 5 maj 2017, për pasojë, si datë e hyrjes në fuqi do të konsiderohet dita e fundit e muajit të gjashtë: *data 5 nëntor 2017*.

Ndërkohë, në nenin 109/par. 1 dhe 3 të ligjit nr. 38/2017 të përmendur (*Dispozitat kalimtare*) thuhet se: “1. Çështjet civile, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë 3. Për çështjet civile, për të cilat është vendosur prishja e vendimit dhe dërgimi i çështjes **për rigjykim**, sipas neneve 467 dhe 485, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij Kodi, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rigjykim do të zbatohen dispozitat e këtij ligji ...”.

Në këto kushte, vlerësohet se në rastin konkret, **vetëm për sa i përket anës procedurale, d.m.th. vetëm sa iu përket rregullave të gjykimit në shkallë të parë që kjo Gjykatë duhet të zbatojë (në rigjykim)**, konkludohet se janë të zbatueshme dispozitat ligjore pas këtyre ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, të cilat kishin hyrë në fuqi në momentin e regjistrimit të çështjes për rigjykim në shkallë të parë në datë 27.9.2022, edhe pse (formalisht) kjo kërkesë ka qenë e depozituar në kryesekretari në

shkallë të parë që më datë 11.9.2009, kjo, sipas parimit se norma *procedurale* civile ndjek një rrugë tjetër nga ajo *materiale* dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor zbatohet norma procedurale në fuqi, për aq sa nuk ka një parashikim të ndryshëm në dispozitat kalimtare.

Në lidhje me zbatueshmërinë e normave procedurale, referuar këtij parimi të përmendur, edhe Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim të tillë, e cila në vendimin nr. 11, datë 23.4.2009, ndër të tjera, është shprehur se: “... në të drejtën procedurale ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe...”.

- Në përfundim të analizës **lidhur me çështjen e ligjit të zbatueshëm**, nisur nga këto parime dhe kritere të zbatueshmërisë së normave ligjore në varësi të natyrës së tyre (norma të natyrës *procedurale*, *materiale* apo **mikse**), kjo Gjykatë konkludon, se:

Rregullat për ritin e gjykimit (d.m.th. për njoftimin dhe legjitimimin e palëve e të përfaqësuesve; për lejin, marrjen dhe debatin mbi provat etj.) dhe veprimet procedurale për gjykimin në shkallë të parë do të ndiqen, përkatësisht, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkesë në vitin 2022–2023 (*në rigjykim*) dhe për aq sa janë të zbatueshme dispozitat e ligjit në fuqi me nr. 110/2016, “Për falimentin”, kjo (vetëm) për sa i përket **anës procedurale** (neni 109, par. 1 dhe 3 të ligjit nr. 38/2017 për ndryshimet në K. Pr. Civile, në lidhje me nenin 211 të ligjit nr. 110/2016), ndërsa në lidhje me kushtet, me rrethanat dhe me kërkesat ligjore për të vlerësuar nëse është apo jo ndonjëra nga situatat që lejon hapjen e procedurës së falimentit, si dhe për faktin nëse subjekti kërkues DRT-ja, si organ i administratës tatimore ka apo jo të kërkojë nisjen e procedurës së falimentimit (d.m.th. për legjitimimin aktiv të palës kërkuese), do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8901/2022, të ndryshuar, si ligji që **në aspektin material** ishte në fuqi dhe, si i tillë, përcaktonte dhe rregullonte kushtet për të nisur ose jo një procedurë falimenti ndaj një shoqërie tregtare si person juridik privat në shtator 2009, kur është depozituar kjo kërkesë (*d.m.th. se për zgjidhjen në themel të çështjes do të zbatohet ligji material në fuqi në kohën kur është paraqitur kërkesa, referuar për këtë nenit 210 të ligjit të ri me nr. 110/2016, si dispozitë kalimtare*).

Së dyti, në kuadër të analizës për bazueshmërinë në ligj e në prova të kërkesës objekt gjykimi dhe në përputhje me rastin konkret, kur në pozitën e palës kërkuese për hapjen e procedurës së falimentit paraqitet një nga organet tatimore të RSH-së (Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë), kjo Gjykatë çmon që të citojë **dispozitat e ligjit nr. 8901/2002**, të ndryshuar:

Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon shprehimisht, se: “Ky ligj ka **për objekt** të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi.”.

Ndërsa, në nenin 2 të tij parashikohet qëllimi i procedurës së falimentimit: “1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose, në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij. 2. Çdo debitori të ndershtëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.

Neni 5, dispozitë e titulluar “Zbatueshmëria e ligjeve të tjera”, ku parashikohet, se: “Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjeve të tjera janë të zbatueshme edhe për procedurën e falimentimit, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji”.

Neni 13 parashikon, se: “1. Procedura e falimentimit hapet **vetëm me shkak**. 2. Gjendja e **paaftësisë paguese** përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar, nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston, nëse debitori nuk kryhen pagesat. 4. **Mbingarkesa me borxhe** përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë ...”.

Neni 14/1 parashikon, se: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e **organeve tatimore**, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare...”.

Neni 15 parashikon, se: “1. Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit ose menjëherë pas dorëzimit të saj, duhet të paraqesin:

a) listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë;

b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, duhet të përmbajë edhe një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

3. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk i kanë dorëzuar të gjitha deklaratat dhe dokumentet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit i kërkon atij plotësimin e tyre. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk e zbatojnë kërkesën e mësipërme brenda 15 ditëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit rrëzon kërkesën e drejtorëve, zyrtarëve, ortakëve apo aksionarëve të shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, për hapjen e procedurës së falimentimit.”

Neni 18/4 parashikon, se: “Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos: c) pranimin e kërkesës dhe **hapjen e procedurave** të falimentimit.”

Neni 26 parashikon, se: “1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit **përmban**: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë, në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit; d) të dhënat e parashikuara në nenet 27 dhe 29 të këtij ligji; e) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës. 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit.”

Së treti, në kuadër të vlerësimit të kushteve ligjore që përcaktojnë çeljen ose jo të procedurës së falimentimit, Gjykata analizon, si më poshtë:

- Referuar kërkesës objekt gjykimi, **me të drejtë sipas palës kërkuese**, vlerësohet se e drejta e saj për t’iu drejtuar Gjykatës, me kërkesë me objekt hapje të procedurës së falimentimit, gjen mbështetje të saktë në nenin 104/pika “c” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon, se: “Fillimi i procedurës së falimentimit në gjykatë **nga administrata tatimore** bëhet në përputhje me ligjin për falimentimin”, ku ky i fundit në nenin 14/1 të ligjit “Për falimentimin”, parashikon, se: “**Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare.**”

Në vijim, pala kërkuese referon në nenin 14 të ligjit “Për falimentimin”, ku përcaktohet shprehimisht dokumentacioni i kërkuar nga ligji që duhet t’i bashkohet kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, në rastin kur kërkesa parashtrohet **nga organi tatimor**, sikundër është rasti konkret. Më konkretisht, pala kërkuese citon nenin 14.1/2 të ligjit, ku thuhet se:

“1/2. Organet tatimore përjashtohen nga pagimi i taksave gjyqësore. Për fillimin e procedurës së falimentimit organet tatimore paraqesin në gjykatë:

d) Kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit;

e) Dokumentacionin e shoqërisë (statutin, aktin e themelimit, numrin e NIPT-it);

f) Bilancin me pasqyrat financiare të shoqërisë, për të cilën kërkohet fillimi i procedurës së falimentimit.”

- Në vështrim të **nenit 14/1** të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar, dispozitë e parë në lidhje me **nenin 104, pika 1/“c”** të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, kjo Gjykatë vlerëson se pala kërkuese Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT) **legjitimohet** në ngritjen e kësaj kërkesë (*legjitimimi aktiv*), pavarësisht faktit se me paragrafin e dytë të nenit 209 të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin” (cituar më lart), neni 104, pika 1/“c” është shfuqizuar.

Për këtë, Gjykata mban parasysh faktin se në momentin e depozitimit të kësaj kërkesë (më datë 11.9.2009), dispozitat në fjalë kanë qenë në fuqi, konkretisht, neni 104, pika 1/“c”, i ligjit nr. 9920/2008, ku parashikohej se organet e administratës tatimore kanë të drejtë që të kërkojnë hapjen e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit e organizuar si shoqëri tregtare, d.m.th. për një person juridik privat, në situatën kur ky i fundit rezulton me një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare, parashikim ligjor që analizohet në lidhje me nenin 14/1 të ligjit nr. 8901/2002 “Për falimentimin”.

Pikërisht, ky parashikim ligjor **në fuqi në momentin e depozitimit të kësaj kërkesë** (më datë 11.9.2009), i parë **në lidhje me parimin e sigurisë juridike**, si një parim kushtetues dhe ligjor (e drejta e fituar me ligj nga një subjekt i së drejtës në një moment të caktuar, nuk mund të humbet me ndryshime të mëvonshme ligjore - shih jurisprudencën e gjerë të Gjykatës Kushtetuese për këtë aspekt), i jep të drejtën palës kërkuuese DRT-së, si organ i administratës tatimore që të drejtën e fituar në vitin 2009, sipas legjislacionit në fushën e falimentimit dhe atij tatimor të vitit 2008, të mos e humbasë dhe ta ushtrojë edhe në vitin 2023, në rigjykimin e çështjes së ngritur nga kjo palë.

Kjo, përderisa dispozitat ligjore kanë qenë në fuqi dhe **pala e ka fituar (tashmë) këtë të drejtë që në momentin e vënies në lëvizje të gjykatës në shtator 2009** (sikundër u tha, me nenin 209/2 të ligjit nr. 110/2016 është shfuqizuar neni 104, pika 1/“c” e ligjit nr. 9920/2008 dhe me paragrafin e parë të po kësaj dispozite është shfuqizuar edhe vetë ligji nr. 8901/2002, “Për falimentimin”), por këto ndryshime dhe shfuqizime nuk kanë efekte juridike *për ato çështje që janë tashmë në proces gjykim* në një shkallë të pushtetit gjyqësor, siç është çështja objekt gjykimi, për të cilën gjejnë aplikim dhe janë të zbatueshme i gjithë kuadri ligjor në fuqi i kohës, në fushën e falimentimit dhe atë tatimor.

Pra, neni 104, pika 1/“c”, i ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, në lidhje me nenin 14/1 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, do të jenë të dyja të zbatueshme në rastin konkret me kërkuues DRT-në si organ i administratës tatimore: *i. qoftë për sa i përket çështjes së legjitimitetit aktiv* dhe interesit të palës kërkuuese në një gjykim të tilla të posaçëm (kjo në vështrim të nenit 32/a të Kodit të Procedurës Civile); *ii. qoftë për sa i përket analizës së kushteve ligjore për hapjen ose jo të procedurës së falimentimit*, nisur nga situata financiare e personit juridik privat si tatimpagues, shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), për të cilën është depozituar kjo kërkesë (kjo në vështrim të neneve 1, 2, 13, 15, 18 të ligjit nr. 8901/2002 për qëllimin, për kushtet dhe për veprimet e vendimarrjen gjyqësore, në kuadër të hapjes së procedurës së falimentimit etj.).

Në vijim të këtij argumentimi, legjislacioni në fushën e falimentimit dhe legjislacioni tatimor, ku pala kërkuuese, DRT-ja, si organ i administratës tatimore mbështet kërkimet e saj sipas kërkesës së depozituar **në shtator 2009**, ligje të cilat kanë hyrë në fuqi **në vitin 2008** (pra, neni 104, pika 1/“c”, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, në lidhje me nenin 14/1 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”) do të jenë në këtë rast të zbatueshme, edhe pse periudha kur kjo shoqëri ka qenë me bilanc negativ për tre vjet të njëpasnjëshëm lidhet me vitet 2006, 2007, 2008, duke qenë se **ligji bazë**, që rregullon këtë procedurë dhe gjykim të posaçëm me nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, **ka qenë në fuqi** në këtë periudhë kur plotësohen kushtet e hapjes së kësaj procedure (neni 13 i ligjit nr. 8901/2002) dhe pala kërkuuese mund të legjitimohet për ngritjen e kësaj kërkesë (neni 14/1 i po këtij ligji).

*Këtu, Gjykata mban parasysh edhe faktin se, lidhur me kushtet ligjore për hapjen ose jo të procedurës së falimentimit me kërkesë të një organi të administratës tatimore (si në rastin konkret), hetimi gjyqësor është shtrirë në mënyrë të plotë dhe shteruese edhe për periudha të mëvonshme nga ato që janë përmendur në kërkesën për gjykim, 2006–2007–2008. Ky hetim është shtrirë, jo vetëm për periudhën 2006–2008, sipas kërkesës për gjykim të depozituar më datë 11.9.2009, por edhe për periudhën kur është dhënë vendimi nr. 2986/2014 (për vitet 2012, 2013, 2014), si dhe për tre vjetët në fund të këtij procesi në rigjykim (konkretisht, për vitet 2021, 2022, 2023), sikundër është thënë më lart në pjesën e **provave shkresore**, që janë marrë kryesisht për hetimin dhe verifikimin e pasurive/aseteve të mundshme të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot “ALSAT” sh.a.), në lidhje edhe me **Raportin e ekspertimit financiar** të përgatitur nga ana e ekspertës/administratores së falimentimit Shpresa Breçani.*

Së katërti, po në kuadër të vlerësimit të kushteve ligjore që përcaktojnë çeljen ose jo të procedurës së falimentimit, Gjykata mban parasysh dhe argumenton se:

- Në përfundim, pas analizës së faktit, të pretendimeve të palës kërkuese dhe analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, ajo duhet të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët në proces.

Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e *paaftësisë paguese* apo në kushtet e *mbingarkesës së tij me borxhe*. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij do të jetë me përfitim për kreditorët ose me synim krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

Kjo Gjykatë vlerëson të theksojë rëndësinë e shqyrtimit të një kërkesë për çeljen e procedurës së falimentimit dhe nevojën për një analizë substanciale të plotësimit të kushteve për fillimin e kësaj procedure. Falimentimi i një subjekti tregtar, synon jo vetëm që të krijojë një situatë ligjore, e cila pasqyron efektivisht pamundësinë e debitorit për vazhdimësinë e mëtejshme të aktivitetit, por që rregullon edhe të drejtat e kreditorëve karshi subjektit debitor, sipas radhës përkatëse të preferimit. *Thënë kjo, në rastet e investimit me një kërkesë për çelje të procedurës së falimentimit, një gjykatë nuk mund të mjaftohet me një analizë formale të pasqyrave financiare, por është përpara detyrimit të analizimit të hollësishëm të gjendjes së pasurisë së debitorit, me qëllim mbrojtjen e dyfishtë, si të subjektit që i nënshtrohet kësaj procedure, po ashtu edhe të kreditorëve dhe të drejtave të tyre respektive karshi pasurisë së debitorit.*

Fillimi, në rrugë gjyqësore, i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit, që në këtë rast parashikohet dhe rregullohet nga dispozitat e ligjit të mëparshëm nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, konkretisht, nga neni 13 i këtij ligji:

- a) gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim; ose/dhe
- b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.

Legjitimitimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit e gëzon kreditori, debitori, si dhe organet tatimore, *në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale trevjeçare, si në rastin konkret, sikundër është analizuar pak më lart te pjesa lidhur me legjitimitetin aktiv të palës kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (subjekt që ka interes dhe të drejtë që i buron nga ligji për të kërkuar hapjen e kësaj procedure).*

- Gjykata çmon se në mbështetje të nenit 12 të K. Pr. Civile, barra e provës për të provuar ekzistencën e paaftësisë paguese të debitorit, personit të tretë në rastin konkret, i takon kërkuarit Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, pasi ai ka iniciuar gjykimin, duke pretenduar se meqenëse personi i tretë është i paaftë për të paguar, duhet të çelet procedura e falimentimit.

Kërkuari Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë arriti që të provojë *në rigjykim* se personi i tretë ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese dhe se, pikërisht, mospërmbushja e detyrimeve të tij tatimore ndaj kërkuarit ka qenë pikërisht rrjedhojë e kësaj paaftësie paguese, **ndërkohë që kjo Gjykatë nuk është mjaftuar me kryerjen e një hetimit vetëm në kuadër të elementeve të nenit 104/1/“c” të ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar (rrethana e humbjeve në bilanc për tre vjetët e fundit të njëpasnjëshëm), por e ka zgjeruar hetimin gjyqësor në rigjykim edhe për sa iu përket verifikimit, vërtetueshmërisë dhe provueshmërisë së kushteve të ligjit të posaçëm të zbatueshëm në rastin konkret, duke hetuar sipas kërkesave të nenit 13 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, edhe për situatën e paaftësisë paguese dhe të mbingarkesës në borxhe.**

Këto dy shkaqe janë më thelbësoret në çeljen e procedurës së falimentimit dhe duhet të marrin vlerësim parësor në krahasim me kushtet e tjera të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji.

Parashikimi i bërë në nenin 14/1 të ligjit të drejtën e organit tatimor të kërkojë çeljen e falimentit, në rast të bilancit me humbje për tre vjet rresht, porse ky parashikim **nuk është një shkak tjetër ligjor për çeljen e falimentit** dhe nuk mund të vlerësohet si një shkak i vetëm që mund të përbëjë shkak për pranimin e kërkesës së DRT Tiranë, edhe pse mund të jetë ekzistent dhe i provueshëm në gjykim.

Kjo, me argumentimin se, duke e parë legjislacionin në tërësi, vetëm fakti që personi i tretë është debitor ndaj organit tatimor në periudhën e viteve 2006, 2007, 2008 (si organ i administratës tatimore në vështirim të nenit 104/1/“c” të ligjit nr. 9920/2008), *nuk do të ishte shkak i mjaftueshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, pa u vërtetuar ekzistenca e shkaqeve të përcaktuara në ligjin “Për falimentimin” për hapjen e kësaj procedure*, si një ligj i posaçëm.

Sipas kësaj Gjykate, neni 104/1/“c” i ligjit 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”, i përdorur si bazë ligjore në kërkimin e kërkuarit, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, e legjitimon administratën tatimore të kërkojë në Gjykatë çeljen e procedurës së falimentimit për shoqëritë tregtare që kanë deklaruar rezultat me humbje të kapitaleve të tyre, të paktën për tre vjet rresht, porse nuk shmanë analizën dhe provueshmërinë e ligjit të posaçëm të zbatueshëm me nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, dispozitat e të cilit me të drejtë janë vendosur si bazë juridike dhe janë analizuar si shkak ligjor nga pala kërkuar e këtij gjykimi (shih nenin 5 të po këtij ligji lidhur me raportin e ligjit nr. 8901/2002 me ligjet e tjera, si dhe hetimin e gjerë gjyqësor në rigjykim, në kuadër të kërkesave për hapjen ose jo të procedurës së falimentimit).

- Duke iu kthyer rastit konkret, me kërkuar Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), për subjektin “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a., sipas historikut të kësaj shoqërie referuar ekstraktit të QKB-së), **Gjykata vlerëson se plotësohen kushtet ligjore për hapjen e procedurës së falimentimit**, kjo duke mbajtur në konsideratë të dhënat nga *provat shkresore*, që janë marrë dhe janë lejuar gjatë hetimit gjyqësor (i. provat shkresore që janë sjellë me kërkesën datë 11.9.2009 apo që janë marrë në kuadër të procesit me vendimin gjyqësor nr. 2986, datë 3.3.2014; ii. provat shkresore që janë marrë kryesisht nga kjo Gjykatë në rigjykim, sikundër është thënë pak më lart në pjesën e provave), si dhe duke pasur parasysh edhe *të dhënat e ekspertimit kontabël* sipas raportit nr. 8050 prot., datë 3.11.2023, të përgatitur nga ana e ekspertes/administratores së falimentimit Shpresa Breçani, në lidhje edhe me përgjigjet sqaruese dhe plotësuese që ajo ka dhënë në seancën gjyqësore të datës 22.12.2023, cituar hollësisht më lart në pjesën e provave.

Në rigjykim, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuarit, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), për ekzistencën e gjendjes së falimentimit të shoqërisë “ALSAT” sh.a. (më parë shoqëria “TV-ALSAT” sh.a.), në zbatim të nenit 18 të ligjit të posaçëm nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, nga ana e kësaj Gjykate është disponuar për caktimin *si eksperte dhe si administratore të përkohshme* të falimentimit ekspertin dhe administratoren Shpresa Breçani (me nr. licence si audituese ligjore 143 dhe me nr. licence si administrator falimenti 9), së cilës iu caktuan si detyra të tilla. si:

i. të verifikojë ekzistencën e shkakut/shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, në drejtim të gjendjes së paafëtisë/paguese të subjektit apo/ dhe mbingarkesës së tij me borxhe;

ii. të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit;

iii. dhënien e një opinioni për të mbikëqyrur veprimtarinë e debitorit, si dhe mundësinë për vijimësinë e veprimtarisë tregtare të debitorit;

iv. për të dhënë një opinion, nëse është e nevojshme që të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë e shoqërisë.

- Nisur nga të dhënat e **provave shkresore** (provat që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. vendimi 2986/2014 dhe ato që janë marrë kryesisht në rigjykim), duke i pasqyruar në rrjedhë kronologjike përmbajtjen e tyre rezulton se:

1. Me vendimin datë 1.10.2013, mbledhja e Asamblesë së re të Aksionarëve të shoqërisë ka miratuar llogaritë vjetore dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor datë 1.1.2012– datë 31.12.2012, **ku shoqëria rezulton me humbje vjetore (-) 30,413,514 lekë**, rrethanë që del nga të dhënat financiare që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. 2986/2014 vendimi, fakt që është bërë objekt kontrolli dhe vlerësimi edhe nga ana e ekspertes/administratores së falimentimit në procesin e zhvilluar në gjykimin e parë.

2. Sipas përlllogaritjeve financiare që janë bërë në kuadër të gjykimit të parë dhe mbi gjendjen ekonomiko-financiare të shoqërisë në atë moment, ka rezultuar dhe është arritur në përfundimin se më datë 31.12.2011, ka ekzistuar shkak real për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë

“TV ALSAT” sh.a., *pasi raporti i aktiveve me detyrimet ka qenë 1:1,49, pra, detyrimet kanë qenë 1,49 herë më të mëdha se aktivet e shoqërisë.*

3. Referuar të dhënave që janë në sistemin tatimor të RSH-së për shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), pala kërkuese, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë (DRT), si organ i administratës tatimore dhe si autoritet publik, ka deklaruar dhe **ka provuar se humbjet e kësaj shoqërie kanë konsistuar në 3 (tre) vjet radhazi të njëpasnjëshëm, konkretisht, vitet 2006–2007–2008 dhe se provat e pretendimet mbi të cilat DRT-ja është mbështetur janë vetë bilancet e depozituara nga kjo shoqëri**, duke qenë kështu e justifikuar dhe e bazuar kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit e depozituar më datë 11.9.2009. Në rastin objekt gjykimi, bashkë me kërkesën për hapje të procedurës së falimentimit, është sjellë në gjykatë midis të tjerave dhe i gjithë dokumentacioni çfarë kërkohej në nenin 14 të ligjit: - *Pasqyrat financiare dhe bilancet e shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. , për vitet 2006, 2007 dhe 2008, ku në këto pasqyra financiare jepen pasuritë (inventarët e ndryshëm), përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra të debive dhe kredive etj.* Pra, aspektin provues dhe në vështirimin ligjor, **shkaku real për hapjen e kësaj procedure ekzistonte në atë moment** (mbështetur në nenin 104, pika 1/“c” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” dhe në nenin 14/1 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, ku të tilla procedura për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës -shih për këtë edhe pretendimet e palës kërkuese DRT në f. 12 të këtij vendimi).

4. Me të drejtë pala kërkuese ka pretenduar ekzistencën e shkakut real për hapjen e procedurës së falimentimit, që në momentin e depozitimit të kësaj kërkesë, më datë 11.9.2009, duke qenë se ka provuar rrethanat e parashikuara nga neni 13 i ligjit nr. 8901/2002, të ndryshuar, rrethana që janë të pranishme e të provuara sipas kësaj Gjykate edhe në rigjykim. Kështu, në mbështetje të provave të administruara në dosjen gjyqësore ka rezultuar e provuar se përgjatë tre vjetëve shoqëria ka qenë në kushtet si vijon: viti 2006, me të ardhura 71,929,195 lekë/shpenzime (-)189,110,994 lekë / *humbje (-) 117,181,799 lekë*; viti 2007, me të ardhura 33,797,716 lekë/shpenzime (-)115,798,997 lekë / *humbje (-) 114,766,562 lekë*; viti 2008, me të ardhura 38,705,206 lekë/shpenzime (-)111,765,651 lekë / *humbje (-) 75,051,445 lekë; totali del me humbje (-) 304,999,806 lekë.*

5. Nisur nga këto të dhëna financiare për periudhën 2006–2007–2008 (totali me humbje: 304,999,806 lekë), me të drejtë pala kërkuese ka pretenduar ekzistencën e shkakut real për hapjen e procedurës së falimentimit që në momentin e depozitimit të kësaj kërkesë më datë 11.9.2009, duke qenë se ka provuar se **në aspektin financiar** mund të vlerësohet që shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. nuk ka pasur mundësi për të gjeneruar të ardhura që mund të përmirësojnë treguesit e saj ekonomikë, apo që të mund të kishte aftësinë paguese të saj, thënë kjo realisht, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka çmuar se ekziston shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit, pasi vazhdimi i aktivitetit tregtar nga ana e shoqërisë është pothuajse i pamundur. Pikërisht, kjo situatë financiare në këtë periudhë si një fakt dhe rrethanë e dokumentuar *në aspektin provues*, ka sjellë depozitimin e kërkesës për gjykim, e bazuar *ligjërisht* në nenin 14/1 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, dhe në nenin 104/1/“c” të ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, duke qenë se është provuar tashmë që në momentin e depozitimit të kërkesës objekt gjykimi, **shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) ka qenë në kushtet dhe në gjendjen e paaftësisë paguese për detyrimet e njohura prej tij ndaj kreditorëve** (referuar bilancit dhe dokumenteve të dorëzuara në gjykatë), d.m.th. është e provuar se shoqëria “TV-ALSAT” sh.a., në këtë rast, nuk i ka përmbushur në kohë detyrimet (referuar bilancit dhe dokumenteve të dorëzuara në gjykatë, po këtu duhet të mbahet parasysh edhe fakti që shoqëria nuk ka publikuar pasqyra të tjera të mëvonshme pas vitit 2014). Nisur nga në situatë e tillë, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, mund të konkludohet se, në këtë rast, ekziston shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri tregtare si subjekt i së drejtës dhe si subjekt tatimpagues, pikërisht, mbi kërkesën e një organi të administratës tatimore.

- Në këtë rast, nga mendimi dhe sugjerimi i ekspertës/administratores së falimentimit të caktuar nga kjo Gjykatë në rigjykim, znj. Shpresa Breçani (të dhënat e ekspertimit kontabël sipas

raportit nr. 8050 prot., datë 3.11.2023, të përgatitur nga ana e ekspertës/administratores së falimentimit Shpresa Breçani, në lidhje edhe me përgjigjet sqaruese dhe plotësuese që ajo ka dhënë në seancën gjyqësore të datës 22.12.2023, cituar hollësisht më lart në pjesën e provave, f. 16–17–18 të këtij vendimi) rezulton se:

i. Për shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) nuk ka dokumentacion tjetër përveç pasqyrave financiare të vitit 2014 për të konkluduar prej ekspertës/administratores së falimentimit lidhur me paaftësinë paguese të debitorit. Pra, pavarësisht veprimeve procedurale të Gjykatës për një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm dhe pavarësisht kohës së dhënë dhe veprimeve që ka kryer pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), është e qartë se në këtë rast **nuk ka dokumentacion për tre vjetët e fundit të shqyrtimit në rigjykim të kërkesës** së depozituar më datë 11.9.2009, d.m.th. se konstatohet që ka mungesë të pasqyrave financiare të tre vjetëve të fundit dhe konkretisht të viteve 2020, 2021, 2022, arsye për të cilën (mungesa e dokumentacionit për këto vite) nuk mund të dilet në një konkluzion mbi paaftësinë paguese aktuale të debitorit sot në momentin e shqyrtimit të kërkesës në rigjykim (porse, kjo situatë ka ekzistuar që në momentin e depozitimit të kësaj kërkesë në shtator 2009, sikundër është thënë pak më lart – *konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

ii. Lidhur me ekzistencën e **mjeteve monetare dhe të likuiditeteve**, nga informacionet e marra nga bankat e nivelit të dytë në rigjykim (nga 12 banka), nuk rezulton gjendje likuiditetesh. Gjithashtu, pjesa më e madhe e llogarive bankare në bankat ku shoqëria ka pasur llogari janë me statusin “të mbyllura”, d.m.th. provohet se nuk ka mjete monetare dhe likuiditete në emër të kësaj shoqërie, të cilat mund të ishin pjesë e përllogaritjeve nga ana e ekspertës/administratores së falimentimit dhe ndaj të cilave mund të vendosej masa e sekuestros/bllokimit (*konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

iii. Sipas dokumentacionit të ndodhur në dosjen gjyqësore (në rigjykim) dhe sipas analizës financiare rezulton se, me shkresën nr. 26149/1 prot., datë 12.6.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, rajoni qendror informon për **vlerën e detyrimeve tatimore të papaguara** deri më datë 12.6.2023, **shumë e cila rezulton të jetë në vlerën 331,630,567 lekë**. Gjithashtu, mbas kërkesës për informacion, me shkresën nr. 110722/1 prot., datë 19.6.2023, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë ka kthyer përgjigje dhe nga informacioni i dërguar rezulton se subjekti “ALSAT” sh.a. **ka detyrime të papaguara në total në vlerën 1,000,772,0 lekë për periudhën 2015–2023**. Pra, është e qartë dhe e provuar se shoqëria është e mbingarkuar në borxhe, sikundër me të drejtë pretendon pala kërkuese DRT (*konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

iv. Nisur nga ky konstatim, se shoqëria “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) *nuk disponon likuiditete* për shlyerjen e detyrimeve të papaguara dhe të evidentuara, sipas dokumentacionit të DRT-së dhe nga institucionet e tjera financiare (detyrime të maturuara dhe që janë bërë tashmë të kërkueshme), mund të konkludohet që kjo shoqëri **është e mbingarkuar në borxhe** me detyrime ende të papaguara, në një gjendje të tillë ekonomiko-financiare, sa mund të konstatohet se është edhe **në kushtet e paaftësisë paguese** (gjendja e mungesës së likuiditetit, e cila është një rrethanë e provuar, tregon se shoqëria nuk ka mjete paguese të mjaftueshme dhe nuk përmbush në afatin e maturimit detyrimet ndaj kreditorëve apo ndaj organeve tatimore dhe institucioneve të tjera, si rrjedhojë plotëson kushtin e gjendjes së paaftësisë paguese për këto detyrime tashmë të maturuara dhe që janë bërë të kërkueshme), e tillë që mund të **konfirmohet se ekzistojnë kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit**, qoftë në vështrim të nenit 13, të ligjit nr. 8901/2002, qoftë në vështrim të nenit 14 të ligjit të ri me nr. 110/2016 (*konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

v. Nga ekzistenca në emër të kësaj shoqërie e pasurisë me nr. 8/578, sikundër është evidentuar hollësisht në pjesën e provave shkresore dhe në raportin financiar të ekspertës, mund të konfirmohet mbi një vlerësim të thjeshtë të pasurisë, edhe pa përcaktuar vlerën e saktë të saj, se **debitori/shoqëria ka mundësi të mbulojë shpenzimet e procedurës së falimentimit**, pra, kjo Gjykatë, në këtë rast nuk është në kushtet e papranueshmërisë direkt të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit,

disponim që bëhet direkt në situatën kur nuk ka pasuri që do të mbulonin kostot e kësaj procedure (*konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

Këtu mbahet parasysh se, sipas ligjit, mbulimi i shpenzimeve të procedurës së falimentimit nga pasuritë dhe likuiditetet e vetë debitorit, është një kusht paraprak që vlerësohet nga Gjykata e Falimentimit për miratimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, në të kundërt, gjykata duhet të bllokojë nisjen apo vijimin e kësaj procedure. Këto pasuri, si rregull, duhet të mbulojnë së paku shpenzimet e kësaj procedure, ndryshe kjo procedurë *nuk hapet* (neni 18/4/“b” i ligjit nr. 8901/2002, të ndryshuar) ose, edhe nëse është hapur, *ndërpritet* për këtë shkak (nenet 171–173 të ligjit nr. 8901/2002, të ndryshuar).

Ndërkohë, sipas ligjit të ri me nr. 110/2016, neni 20 parashikon që gjykata mund të vendosë që të mbyllë procedurën e falimentimit, kur pasuritë e debitorit janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e procedurës së falimentimit, duke iu dhënë kreditorëve mundësinë për të kundërshtuar, një mundësi që mungonte dhe nuk parashikohej në legjislacionin e mëparshëm lidhur me procedurën e falimentimit, d.m.th. se kjo mundësi nuk parashikohej në dispozitat e ligjit nr. 8901/2002, që është i zbatueshëm në rastin objekt gjykimi.

vi. Nisur nga të dhënat për dokumentacionin e munguar financiar (nuk ka balance dhe as pasqyra financiare) të kësaj shoqërie që nga viti 2014, nisur nga fakti që vetëm formalisht në QKB shoqëria figuron me statusin aktiv, porse në realitet prej rreth 10 vjetësh nuk ka aktivitet financiar të pasqyruar dhe të dokumentuar në organet tatimore të RSH-së, sipas ekspertës nuk mund të jepet një vlerësim mbi aktivitetin dhe vazhdimësinë e veprimtarisë, pra, ***nuk është prezent opsioni për një plan riorganizimi dhe shëndetësimit financiar*** të kësaj shoqërie (*konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

vii. Nisur nga të dhënat e përmendura më lart, duke qenë se janë në fuqi disa urdhra përmbarrimorë, të cilët mund të shtohen në të ardhmen bazuar kjo në situatën financiare të debitorit, *nga ana e ekspertës/administratores së falimentimit vlerësohet* se rreziku i ekzekutimit të pasurive është i lartë. Si rrjedhojë, **sugjerohet si e nevojshme vendosja e masave të përkohshme**, me qëllim sigurimin e pasurive të debitorit, shoqërisë “ALSAT” sh.a., marrja e një mase të tillë është në interes të kreditorëve, për sa i përket situatës aktuale në të cilën ndodhet debitori, duke evidentuar këtu se (aktualisht) ka vetëm një pasuri të paluajtshme në emër të kësaj shoqërie, ndërsa në Regjistrin e Barrëve Siguruese (RBS) ka vetëm urdhra bllokimi, porse nuk rezultojnë pasuri të identifikuara në emër të shoqërisë në fjalë (*konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

viii. Në përfundim, **sugjerohet hapja e procedurës së falimentimit** për shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), pikërisht, për shkak se provohet gjendja e paaftësisë paguese dhe situata e mbingarkesës në borxhe (*konstatim dhe vlerësim i gjykatës edhe në rigjykim*).

- Nga sa më sipër: **i.** duke pasur parasysh **subjektin kërkues**, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT), dhe legjitimitetin e këtij organi të administratës tatimore në ngritjen e kërkesës objekt gjykimi (neni 14/1 i ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, si ligji i zbatueshëm për legjitimitetin e palës kërkuese, që në këtë rast nuk është debitor/kreditor dhe për kushtet ligjore për hapjen e kësaj procedure, aspekte këto të analizuar më lart); **ii.** duke marrë në konsideratë rrethanat e provuara ku dokumentohet qenia e subjektit tatimpagues *me humbje së paku tre vjetët e fundit* në periudhën 2006–2007–2008 dhe, në vijim, duke parë të provuar gjendjen e *paaftësisë paguese dhe mbingarkesën në borxhe*, sipas provave shkresore dhe raportit të ekspertës/administratores së falimentimit Shpresa Breçani, situata të cilat secila përbëjnë secila **një shkak për hapjen e procedurës së falimentimit**, shkak që provohet se ka ekzistuar dhe që provohet se qëndronte ligjërisht që në momentin e depozitimit të kësaj kërkesë, më datë 11.9.2009, në momentin e dhënies së vendimit nr. 2986/2014, dhe sot në rigjykim (neni 13 i ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, si ligji i zbatueshëm); **iii.** duke pasur në konsideratë mendimin dhe përfundimin në raportin financiar se ka pasuri të mjaftueshme **që mbulojnë shpenzimet dhe koston e procedurës së falimentimit**, ndaj, një kërkesë e tillë nuk mund të deklarohet e papranueshme për këtë rrethanë; **iv.** duke pasur parasysh mendimin dhe përfundimin e raportit financiar dhe të dhënat nga provat shkresore, sipas të cilave **nuk mund të**

realizohet në rastin konkret një plan riorganizimi për shoqërinë dhe nuk mund të mbahet në aktivitet për shëndetësimin financiar, duke i parë në tërësi këto aspekte dhe kërkesa të ligjit që rezultojnë të hetuara dhe të provuara në rastin konkret, **sipas kësaj Gjykate, në rigjykim arrihet në përfundimin se janë kushtet ligjore për hapjen e procedurës së falimentimit**, përderisa rezultojnë të provuara *të dyja rrethanat* që ligji i posaçëm i parashikon si një shkak të domosdoshëm për hapjen e procedurës së falimentimit.

Sa më lart dhe në përfundim të hetimit gjyqësor, në kushtet kur vërtetohet ekzistenca e dy prej shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, siç janë *mbingarkesa me borxhe* dhe *paaftësia paguese*, në bazë të neneve 18/4/“c” dhe 26 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar, çmon se duhet të vendosë *pranimin e kërkesës* dhe *hapjen e procedurës së falimentimit* të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), *duke emëruar* si administratore të falimentimit znj. Shpresa Breçani.

Të gjithë kreditorët e shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) duhet të paraqesin pranë administratores së falimentimit **pretendimet e tyre**, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), **për raportim**, duhet të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), **për verifikim**, duhet të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve të tyre. Ky disponim lidhet me faktin që vetë ligji ka synim që të organizojë kreditorët për të mos u futur secili në mënyrë të ndarë dhe individuale në një proces të veçantë për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në përfundim të këtij gjykimi, për shqyrtimin e kësaj kërkesë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) shpallet publikisht dhe duhet t’iu njoftohet të gjitha subjekteve të specifikuar në pjesën urdhëruese të këtij vendimi, si dhe çdo subjekti që administron regjistra publikë pronësie, apo të drejta pronësie dhe publikohet sipas përcaktimeve të mëposhtme. Në parim, nevojitet që të ketë *një ekuilibër* midis së drejtës së publikut për të ditur se çfarë ndodh me procedurën e falimentimit dhe nevojës për të shmangur shkeljen e panevojshme të së drejtës së debitorit për privatësi, megjithëse vetë debitori nuk ka asnjë të drejtë ligjore që të vendosë po ai për publikimin ose jo të vendimit gjyqësor.

Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar, urdhërohet si më poshtë:

- publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), *në Buletinin e Njoftimeve Publike*;

- një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet *Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)*;

- një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), t’i dërgohet *Ajencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK)*, me qëllim njoftimin e të gjitha drejtorive vendore të ASHK-së dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar;

- një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’iu dërgohet të gjitha *bankave të nivelit të dytë* në Republikën e Shqipërisë;

- një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet *Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve* dhe *Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*;

- një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet *Autoritetit Rrugor Kombëtar*;

- publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

- publikimi dy herë i vendimit të shkurtuar për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Telegraf”.

Bazuar në nenin 8/2 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), për kryerjen e njoftimeve dhe të shpalljeve publike, sipas nenit 9 të ligjit dhe për caktimin e mbledhjeve brenda afateve të parashikuara në këtë vendim, ngarkohet administratorja e falimentimit znj. Shpresa Breçani.

Shpenzimet në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen *masës së falimentimit* (si rregull, masa e falimentimit përfshin: pasurinë që është në zotërimin e debitorit dhe që i përket atij; pasurinë që i përket debitorit, por që është në pronësi të dikujt tjetër; pasuri ose llogari të arkëtueshme që i detyrohen debitorit; të ardhurat nga pasuria e debitorit, si p.sh. nga qiraja, nga shitja etj.; kuotat e debitorit në një biznes apo nga një pasuri martesore etj.). Si rrjedhim, një kopje e këtij vendimi duhet t’i njoftohet dhe administratores së falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), znj. Shpresa Breçani.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, që përbëhen nga taksa mbi aktet, nga shpenzimet për ekspert dhe nga shpenzimet për njoftime, bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, në këtë fazë të procesit, i ngarkohen palës kërkuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 125, 306-310, 443–444 të Kodit të Procedurës Civile, në nenin 26 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008),

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.
2. Hapjen në orën 11:30, të datës 28.12.2023, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), shoqëri e regjistruar në QKB me NUIS: K21407006R, me adresë dhe seli të shoqërisë në Tiranë, rruga “Siri Kodra”, pranë ish-Frigoriferit.
3. Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) znj. Shpresa Breçani, atësia Dem, amësia Hajrie, e datëlindjes 20.3.1964, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me licence nr. 09 dhe NIPT: K71529023K, me adresë: rruga “Panorama”, pranë Hipotekës, pallati “Sara-El”, kati I, apartamenti I.
4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), duhet të paraqesin pranë administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani, pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), duhet të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit znj. Shpresa Breçani, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.
6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, ndaj shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), duhet t’i paguajnë dhe t’i shlyejnë ato pranë administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani.
7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), për raportim, duhet të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), për verifikim, duhet të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve të tyre.
9. Ndalohet çdo veprim ekzekutimi mbi të gjitha pasurinë e debitorit, të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), nga çdo kreditor apo palë tjetër gjatë procedurës së falimentimit, qofshin këto pasuri materiale apo të drejta.

10. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), në Buletin e Njoftimeve Publike.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), t’i njoftohet administratores së falimentimit për këtë shoqëri, znj. Shpresa Breçani.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.), t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), me qëllim njoftimin e të gjitha drejtorive vendore të ASHK-së dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’iu dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar në Tiranë, Autoritetit Portual në Durrës, si dhe Zyrës së Regjistrimit të Barrëve Siguruese në Tiranë.

18. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

19. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

20. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

21. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TV-ALSAT” sh.a. (sot shoqëria “ALSAT” sh.a.) në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Telegraf”.

22. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuuese.

23. Kundër vendimit të arsyetuar mund të bëhet **ankim i veçantë** në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda **5 (pesë) ditëve**, duke filluar ky afat **për të gjitha palët** nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar nga ana e kryesekretarisë.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 28.12.2023, ora 11:45.

SEKRETARE
Anjeza Nergjoni

GJYQTAR
Niko Rapi